

**Seancë
e përbashkët
Avancohet
bashkëpunimi
bilateral**

Fq.3



**RAPORT PËR
GJYQËSORIN**
Zgjedhjet e
gjykatësve nuk
arsyetohen

Fq.5




**APOEL
interesoheret
për
Avdijajn**

Fq.19



Koha

www.koha.mk



**KOHA për
enigma**

Fq.11-14

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3246 · e shtunë / e diel 16-17 dhjetor 2017

0°C | +6°C

15 DEN

AKTUALE

**Kodra e
Diellit pret
decentra-
lizimin!**



Me dekada të tëra flitet për potencialin e madh turistik dhe zhvillimin e Kodrës së Diellit në qendër të madhe dhe moderne të sporteve dimërore. Megjithatë, të gjitha planet për zhvillimin e saj, si duket kanë mbetur në letër, përderisa në të njëjtën kohë qendrat rajonale si Bansko apo Ko-paoniku janë shndërruar në perla të vërteta...

Fq.6

DOSSIER

**Asnjë arsye
nuk ka që
ndalon
lëvizjen e
lirë për
Kosovën**

Fq.16

GLOBI

**Kur
arrestohen
dhe abuzohen
fëmijët!**

Fq.17



JAVA E ARDHSHME, VENDIMTARE PËR POSTET QEVERTARE

ASH PJESË E QEVERTISË, ME OSE PA SHËNDETËSINË



Sipas asaj që thonë për gazetën KOHA, funksionarë të lartë të ASH-së, kjo parti nuk e ka patjetër që të mbajë dikasterin e shëndetësisë, por se mund të pajtohet edhe me dikaster tjetër qeveritar, përfshi edhe atë zëvendëskryeministër për reforma

Fq.3

Fitojnë tenderë edhe ata me 0.01 denarë

Shkup, 15 dhjetor - Në Maqedoni realizohen tenderë edhe me çmime absurde prej 0.01 denarë. Sipas raportit të fundit të Qendrës për Komunikime Qytetare, që ka ndjekur furnizimet publike për periudhën janar-qershor 2017, çmimi më i ulët si kriter i vetëm për zgjidhje, na shpjen ndaj tenderëve me çmime absurde prej 0.01 denarë dhe 0.01 për qind. Jologjikshmëritë e tilla të tregut vetëm e rrisin rrezikun nga ma-

nipulimet e mundshme në realizimin e tenderit shton më tej raportit. "Në tenderët që ishin lëndë e monitorimit në gjysmën e parë të 2017-ës, marrëveshjet e shërbimeve për 0.01 denarë, ishin nënshkruar për furnizimin me shërbimin e operatorit celular, dhe për shërbimin e agjencisë së marketingut për përkrahje të marketingut, ndërsa çmimi prej 0.01 për qind i shërbimit ishte për angazhimin e agjencisë..."

Fq.7



NË FOKUS

IDEOLOGJIA E VJETËR



Ismet TOTO

Lufta e hapur e dy mendësive kundërshtare në vendin tonë, duke mbaruar procesin latent të kundërshtimit historik të tij, më 21 tetor 1935, përfundoi, në fazën e parë, me fitimin e Ideologjisë së re, e cila përfaqësohet prej elementave që formojnë "Elitën e djalërisë intelektuale" të Atdheut tonë. Ky triumf historik i frymëzuar prej shpirtit të pastër të intelektualëve të vërtetë dhe i përgatitur nga fuqitë morale dhe materiale të popullit, gjeti përkrahjen e merituar të pushtetit dhe me këtë mënyrë, në historinë e evolucionit ideologjik dhe politik të popullit tonë caktoi pikënisjen e zhvillimit normal të parimeve moderne në organizim shtetrorë dhe pikëmbarrimin e sundimit të mentalitetit oriental, i cili ka pasur në dorë gjithë fatin e Atdheut duke e qeverisur si mbas parimeve të kohrave para Tanximatit! Pra, dushi i akullt, që qëlloi pa prituri e pa kujtuar avangardistët e ideologjisë së vjetër më 21 tetor, i plevitosi të tërë antarët e saj, të cilët në këto dhjetë vjetët e fundit nuk kanë pranuar asnjë dhimbje në trupin e tyre të ushqyer mirë me mjerimet dhe me djersën e popullit. Tani ky trup i plevirosur është në agoninë e minutave më kritike të jetës politike! Por, si duket, trupi i sëmurë përpiket gjithnjë që të mos i dorzojë djallit shpirtin e zi! Kërkon të marrë fuqi për të sulmuar edhe një herë trupin e njomë të djalërisë intelektuale, e cila sapo nisi të marrë frymë të lirë në atdheun e vet. Gjendemi, pra, në fazën, e fundit të përpjekjes së rreptë, e cila kësaj here nisi të zhvillohet në ariergardën e fushës së luftimit, duke pasur si pusi të sigurt kulltuqet dhe bankot parlamentare. Po bëhet një luftë decisive, në të cilën dhelprat e vjetra janë duke zbatuar të tërë marifetet e tyre të zakonshme: provokacionin, insinuationin dhe sabotazhin! Domosdo me ndryshimin e fizionomisë politike të djalërisë intelektuale, e cila zuri vendin e merituar në organizim shtetrorë të vet, ndryshoi edhe taktika dhe strategjia e luftimit të adversarit, i cili tani është duke manevruar në çdo mënyrë që të na qëllojë nga prapa, bile të na qëllojë me armët tona, të cilët janë: "gabimet" e rritjes, e zhvillimit dhe e entuziazmit tonë. Dua të them, na luftojnë duke i paraqitur si gjëra të këqija e të rrezikshme rritjen dhe entuziasmin tonë. 21 tetori, si ç'e lypte konsequenca e llogjikës, provokoi një reaktion të fortë në përfaqësuesit e ndryshëm të ideologjisë së vjetër duke i bashkuar rrethotull Qendrës. Kështu shpjegohet bashkimi i disa tipave të ndryshëm, i disa ekstremave, bile, reaktionare, të cilët, në këto ditët e fundit, formuan Frontin e tyre të përbashkët dhe, si ç'është ata, të shënjtë, duke mos e cilësuar me asnjë mbiemër politik.

Si ç'duket, ideologjisë së vjetër, në kohrat e sotme, s'para ia ka qejfi të dëgjojë epitete politike si "liberale", "demokrate", sidomos shumë zët e ka "lirinë e shtypit", sepse këto fjalë, të mprehta si maja thikash, u ngulën në zemër zotërinjve konservatorë duke u prishur rehatin e shtruar dhe gjumin e ëmbël, dhe duke u kujtuar edhe mbase, kohrat të këqija...! Agonia e konservatorëve është e tmerrshme: ata në delirium shofin rrëzimin e tyre bashkë me të gjitha konsequencat, që sjell me vete ky rrëzim! Adio me kolltuqet dhe boll para! Prandaj hidhen dhe çirren për të evituar katastrofën e paevitueshme! Por tepër vonë, historia s'vete më prapa! Kundrejt kësaj agonie të rrezikshme, sjellja e djalërisë intelektuale duhet caktuar brenda kufive të interesave të saj historike: agonisë së egër plot ethe e delirium, djalëria duhet t'i përgjigjet duke formuar frontin kompakt të përbashkët, duke caktuar taktikën sistematike të luftës dhe duke i thënë ndonjë shoku që friksohet. "Non ti curar di lor, ma guarda e passa". (Botuar më 1936)

NË MARS HIQEN VIZAT

"Kosovarët mund të lëvizin pa viza para muajit mars të vitit që vjen. Gjithashtu edhe FSK-ja para atij muaji, mund të shndërrohet në ushtri të Kosovës. Për këto dy çështje dhe shumë të tjera do të udhëtojë më 18 dhjetor në Bruksel. Është hera e parë që për liberalizimin e vizave dhe formimin e ushtrisë së Kosovës, ka një afat kohor e që është marsi", shkruan kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj në profilin e tij zyrtar në Facebook.



KRITERET IDEOLOGJIKE

"Problemet ideologjike, ato sociale, ekonomike, kulturore, etj. në Programet partiake Kosovare zënë vend sa për sy e faqe, apo të paktën të identifikohen me standardet unifikuese vetëm për të dërguar sinjale se janë si simotrat tjera në rajon dhe Evropë. Sipas kriterit ideologjikë tashmë të njohur, partitë politike duhet të përfaqësohen me petkun ideologjikë, i cili më vonë ato i apostrofon si të majta, të djathta apo të mesit. Në Kosovë, si fenomen që është evident gjatë gjithë periudhës së pasluftës kemi në njërin anë prononcime pro et contra këtij sistemimi logjikë të këtyre organizatave, kurse në anën tjetër veprimet e tyre shpesh ndodhë që të bien në kundërshti edhe me vetë statutin, ideologjinë dhe vetë programin e tyre?! Kosovës, duket që i mungon edhe një tip i partisë që nga disa shquhet si parti kadrovike, apo unë kisha më thënë parti teknokratësh (njerëzish të rëndësishëm dhe me reputacion të suksesit në sferat e biznesit në terrenin lokal) të cilët duke qenë të pakënaqur më mënyrën qeverisëse të pandanëve marrin iniciativë të ofrojnë programe (kryesisht) ekonomike vetëm e vetëm të rrisin bizneset e tyre lokale", shkruan sociologu kosovar, Fadil Maloku.



TA MBROJMË BASHKË FAMILJEN...

"Si një anëtar i ri i organizatës, por aktivist i vjetër i Vetëvendosjes në bindje e parime, ju kërkoj përzemërsisht e miqësisht, të ndaloni fyerjet, linçimet, hatërmbetjet ndaj njëres a tjetres palë. T'i ndaloni për hir të atyre që ju besuan e na besuan, t'i ndaloni për hir të gjyshërve e fëmijëve tanë. Për hir të një angazhimi epik 12 vjeçar! Duke qenë se Lëvizja ka shumë armiq, duke qenë edhe se Lëvizja është shpresa e fundit për rimëkëmbje e ndryshim, le të afrohem i të duhemi si vëllezër e motra, t'i kthehemi njëri-tjetrit bashkë, si pjesëtarë e një familjeje. Albini, Dardani, Aida e Shpendi, janë pjesë të familjes së madhe, Vetëvendosje! Ta mbrojmë bashkë këtë familje", shkruan shkrimtari, njëherësh aktivist i Lëvizjes Vetëvendosje, Avni Tafili.



KUSH E BËN LIGJIN?

"Ligjin e bëri njeriu për njeriun; për ta mbrojt njeriun nga njeriu. Përgjigja ime dhënë studentëve-sot, në pyetjen: çka është ligji?", shkruan në profilin e tij në Facebook profesori universitar, Blerim Reka.



MEDIACitate

Drejtori i "Trepçës", Ahmet Tmava, ka ripërsëritur se Qeveria e Kosovës është vonuar për ta formuar bordin mbikëqyrës, pa të cilin Ligji për "Trepçën" nuk mund të jetësohet, ndërsa pas mbylljes së konkursit mund të shkojë edhe një muaj për t'u zgjedhur bordi mbikëqyrës. Për pasojë, rënia e prodhimit në "Trepçë" në 6 muajt e parë të këtij viti ka rënë për 30 për qind. Gjendja në "Trepçë" edhe një vit pas miratimit të Ligjit për "Trepçën" në Kuvendin e Republikës së Kosovës vazhdon të jetë e njëjtë, as me AKP-në e as me Qeverinë e Kosovës, e cila ka 80 për qind të aksioneve të saj.

(Telegrafi, 15 dhjetor)

Presidenti rus Vladimir Putin i hodhi poshtë akuzat për ndërhyrjen ruse në zgjedhjet presidenciale të Shteteve të Bashkuara dhe tha se kundërshtarët e Presidentit Trump i kishin përhapur ato me synimin për të minuar legjitimitetin e tij. Këto komente Presidenti rus i bëri sot në konferencën e tij vjetore të shtypit në Moskë. Ai shprehu shpresë se marrëdhëniet mes Shteteve të Bashkuara dhe Rusisë do të normalizohen. Agjencitë amerikane të zbulimit kanë arritur në përfundimin se Putin ka urdhëruar një fushatë, e cila synonte të ndikonte tek zgjedhjet amerikane, me preferencën që zoti Trump të fitonte garën me rivalin e tij, ish Sekretaren e Shtetit Hillary Clinton. Presidenti Trump ka thënë se ekipi i fushatës së tij nuk ka bashkëpunuar me rusët.

(Reuters, 10 dhjetor)

Përçarjet që janë shpërfaqur në partinë më të madhe opozitare, në lëvizjen "Vetëvendosje", e cila njëherësh ka qenë partia më e zëshme në Kuvend, i konvenojnë më së shumti koalicionit qeverisës. Kështu vlerësojnë analistët politikë në vend, duke shtuar se koalicioni qeveritar nuk është stabil pasi ka vetëm 61 vota në Kuvend dhe çdo iniciativë serioze e opozitës do të mundëta rrëzonte Qeverinë. Sipas tyre, opozita në vend se "ta luftonte" Qeverinë, ka disa ditë që po përballet me një luftë të brendshme.

(Zëri, 15 dhjetor)

NËSE NUK E KENI DITUR...

HISTORIA E BUTRINTIT

Butrinti është qytet i lashtë në Epir, i vendosur mbi një kodër të gadishullit të Ksamilit, buzë liqenit me të njëjtin emër, 15 km në jug të Sarandës. Në burimet e shkruara përmendet për herë të parë

nga fundi i shek. VI p.e.s. Bënte pjesë në bashkësinë (koinonin) e kaonëve dhe më vonë në shtetin e Epirit. Në kohën e Jul Cezarit u kthye në koloni romake. Pastaj qyteti ndoqi fatet e Perandorisë Romake dhe të asaj Bizantine. Më vonë hyri në zotërimet e Venedikut (1690-1797), prej të cili e shkëputi Ali Pashë Tepelena. Me rënien e pashallëkut të Janinës, Butrinti kaloi nën sundimin osman, që zgjati deri më 1913.



JAVA E ARDHSHEME, VENDIMTARE PËR POSTET QEVERTARE

Sipas asaj që thonë për gazetën KOHA, funksionarë të lartë të ASH-së, kjo parti nuk e ka patjetër që të mbajë dikasterin e shëndetësisë, por se mund të pajtohet edhe me dikaster tjetër qeveritar, përfshi edhe atë zëvendëskryeministër për reforma

ASH PJESË E QEVERISË, ME OSE PA SHËNDETËSINË



Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 15 dhjetor - Aleanca për shqiptarët do të vazhdojë të jetë pjesë e Qeverisë deri në Samitin e NATO-s në qershor të vitit të ardhshëm, pas të cilit mund të ketë rikonstruim të gjerë të Qeverisë, pa mos përjashtuar as zgjerimin e koalicionit qeveritar. Sipas asaj që thonë për gazetën KOHA funksionarë të lartë të ASH-së, kjo parti nuk e ka patjetër që të mbajë dikasterin e shëndetësisë, por se mund të pajtohet edhe me dikaster tjetër qeveritar, përfshi edhe atë zëvendëskryeministër për reforma, por që të merr përsipër planin aksional 3-6-9 për reformat në vend dhe të udhëheqin si parti me drejtoritë, për të cilët janë marrë vesh më herët. Ky pritjet të jetë qëndrimi i ASH-së në raport me pozicionin e saj në Qeveri, i cili do të qartësohet edhe më shumë kur do të realizohet takimi Zaev-Sela, pasi që ky i fundit të kthehet nga SHBA-së.

"Është vetëm një insistim i BDI-së që me çdo kusht të krijojë situatën që ne të dalim vetë nga qeveria, por që ky insistim nuk do të ketë sukses. Jo pse ne kemi aq dëshirë të jemi në pushtet, por për

shkak të rrethanave politike dhe faktorit ndërkombëtar, që po ndihmojnë qeverinë në realizimin e reformave. Ne do të vazhdojmë të jemi pjesë e Qeverisë, sigurisht deri në samitin e NATO-s në qershor. Pas këtij Samiti, Qeveri mund të pësojë ndryshime substanciale, ndoshta do të zgjerohet me më shumë partner në koalicionin", thonë funksionarë të lartë të ASH-së. Sipas tyre, shëndetësia nuk është kusht që patjetër ta udhëheqin, por ASH mund të drejtojë ndonjë ministri tjetër të rëndësishme. "Presim të kthehet kryetari Ziadin Sela nga SHBA që të takohet me kryeministrin Zoran Zaev. Nëse Zaev do të mbajë pozicione të BDI-së, që përmes ministrit pa resor të bëjë situatën që ne të dalim nga qeveria, atëherë ASH mund të diskutojë pozicionin e saj në Qeveri.

Nëse Zaev flet me gjuhën e tij dhe shpreh qëndrime partiake, pra të LSDM-së, ne do të diskutojmë pozicionet ministore, mund të jemi të kënaqur me ndonjë ministri tjetër apo zëvendëskryeministër për reforma, por jo në cilësinë e ministrit pa resor, por zëvendëskryeministër që do të udhëheq më planin aksional 369 për reformat në vend si dhe të mbajmë drejtoritë për të cilët jemi marrë vesh më herët", theksuan funksionarë të ASH-së.

Nga ana tjetër, koordinatori i Grupit parlamentar të LSDM-së, Tomislav Tuntev, thotë se bindja e tij personale është se ASH do të vazhdojë të jetë pjesë e Qeverisë, por se çfarë pozicioni do të ketë, Tuntev thotë se për atë duhet të flasin liderët partiak. "Sot në seancë ishin prezent deputetë nga Aleanca për Shqiptarët, që do të thotë se

nuk kemi problem me shumicën parlamentare. Sa i përket pozitës në Qeveri, bindja ime është se kjo parti do të jetë pjesë e qeverisë, por se çfarë pozicioni do të mbajë këtë duhet ta thonë liderët partiak", tha për gazetën KOHA, Tomislav Tuntev nga LSDM. Ndryshe, Agjencia e lajmeve MIA, ditë më parë doli me informatë se ASH do të mbetet jashtë qeverisë, duke iu referuar një deklaratë të deputetit të BDI-së, Artan Grubi, kur tha se, "kanë përfunduar bisedat midis Zaevit dhe Ahmetit. Por për të sqaruar këtë më në detaje, gazeta KOHA mori përgjigje tjetër nga Grubi. "Unë nuk kam folur për ASH-në, por vetëm kam thënë se Zaev dhe Ahmeti kanë folur më herët për plotësimin e vendeve në Qeveri. Deri më tani ende nuk ka një vendim në partiak se kush do jenë emrat për postet

qeveritare", tha për gazetën KOHA, deputeti Artan Grubi, njëkohësisht shef i Kabinetit të kryetarit të BDI-së, Ali Ahmeti.

Burime të gazetës KOHA, të afërta me anëtarë të Kryesisë Qendrore të BDI-së, thanë se nuk ka pasur takim këto ditë mes Ahmetit dhe Zaevit, por MIA i është referuar takimit të mëhershëm që kanë pasur liderët partiak. "Nuk është e vërtetë se ka pasur takim Ahmeti-Zaev, por MIA ndoshta i është referuar takimi të mëhershëm që patën liderët partiak".

Ndryshe një javë më parë nga LSDM, anëtar të Kryesisë Qendrore, referuan në mënyrë anonime për gazetën KOHA se ASH më shumë gjasa ka që të mbajë shëndetësinë deri në një rikonstruim më të gjerë të Qeverisë, në pranverë të vitit të ardhshëm.

SEANCË E PËRBASHKËT E QEVERTARE TË MAQEDONISË DHE SHQIPËRISË

Avancohet bashkëpunimi bilateral



Pogradec, 15 dhjetor - Qeveritë e Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë, të premtën në qytetin e Pogradecit, e filluan seancën e parë të përbashkët, në rend dite të së cilës do të jenë disa tema të orientuara drejt avancimit të bashkëpunimit bilateral, njoftoi raportuesi i MIA-s. Ekipi qeveritar i Maqedonisë me përbërje të plotë, me nderime më të larta shtetërore dhe me intonimin e himneve i ka pritur kryeministri i Shqipërisë Edi Rama, ku më pas filloi edhe

pjesa e punës të takimit.

Në këtë takim të rëndësishëm është biseduar për çështje nga sfera e ndërlidhjes infrastrukturore, ndërtimit të Korridorit tetë, për lehtësim dhe intensifikim të këmbimit të mallrave dhe shërbimeve dhe për përfundimin e bashkëpunimit në sferën e sigurisë.

Në seancë është planifikuar të nënshkruhen disa dokumente për bashkëpunim, përfshirë edhe planin për konsultime mes Ministrive të Punëve të Jashtme, memoran-

dum mes Ministrive të Punëve të Brendshme për bashkëpunim në sferën e kontrollit të brendshëm, si dhe për formim të komitetit të përzier për bashkëpunim ekonomik. Nga sfera e arsimit dhe shkencës, do të nënshkruhet memorandum për bashkëpunim intensiv bilateral përmes Institutit për Trashëgimi Kulturor dhe Shpirtërore të Shqiptarëve nga Republika e Maqedonisë. Në mënyrë shtesë do të nënshkruhet edhe memorandum për bashkëpunim në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, si dhe marrëveshje për bashkëpunim në parandalimin e krizave.

Pas mbajtjes së seancës së përbashkët është paralajmëruar konferencë e përbashkët për media e kryeministrave të Maqedonisë dhe Shqipërisë Zoran Zaev dhe Edi Rama. Të shtunën, kryeministrat e Maqedonisë dhe Shqipërisë do ta vizitojnë Pustecin, ku do të takohen me përfaqësues të vetëqeverisjes lokale dhe do ta vizitojnë shkollën ku do të dhurojnë pajisje për nxënësit.

Liderët e Ballkanit të hënën në darkë te Mogherini



Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme e Siguri, Federica Mogherini, të hënën, më 18 dhjetor në Bruksel, do t'i tubojë kryeministrat e gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor. Siç njoftojnë medie, në darkë janë ftuar kryeministrat nga Kosova, Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia, Serbia dhe nga Bosnjë e Hercegovina. Para darkës së përbashkët të punës, Mogherini do të zhvillojë takime të shkurtra bilaterale me secilin pjesëmarrës.

SHTYHET DEBATI PËR BUXHETIN

DITA "D" MË 22 OSE 24 DHJETOR

Deputetët e VMRO-së para seanca plenare, deklaruan se nuk do të marrin pjesë në debatin për Propozim buxhetin për vitin e ardhshëm, ndërsa pranimin e amendamenteve të VMRO-së, nga anëtarët e Komisioni për buxhet dhe financim, i vlerësojnë sy dyfytirësi e shumicës parlamentare

Koha

Zejnulla VESELI

Shkup, 15 dhjetor – Seanca plenare për fillimin e debatit për Propozim buxhetin e viti 2018, e caktuar për ditën e premte (15 dhjetor), u shty për 22 dhjetor, gjegjësisht të premtën e ardhshme. Sipas shërbimeve të Parlamentit, kjo ndodh për shkak të mungesës së disa deputetëve të shumicës parlamentare, të cilët po zhvillojnë aktivitete zyrtare jashtë Parlamentit të Maqedonisë. Deputetët e VMRO-së para seanca plenare, e caktuar për në ora 11, deklaruan se nuk do të marrin pjesë në debatin për Propozim buxhetin për vitin e ardhshëm, ndërsa pranimin e amendamenteve të VMRO-së, nga anëtarët e Komisionit për buxhet dhe financim, i vlerësojnë sy dyfytirësi e shumicës parlamentare.

"Deputetët e VMRO-së nuk do të marrin pjesë në seancën plenare për buxhet, sepse bëhet fjalë për buxhetin më të madh në historinë Maqedonisë, ndërsa sa i përket amendamenteve të pranuar nga anëtarët e Komisionit për buxhet dhe financim, kjo njëherit tregon për dyfytirësinë e deputetëve të shumicës parlamentare, sepse bëhet fjalë për amendamente që



në vete kanë një shumë të vogël parash", tha Ana Lashatovska, deputete e VMRO-së.

Lëvizja BESA thotë se arsye se pse shtyhet seanca për Propozim buxhetin është për shkak se një kohë të gjatë në Parlament nuk kemi stabilitet të shumicës parlamentare në sallën e Kuvendit. "Kur bëhet fjalë për dokument shumë të rëndësishëm, siç është debati për miratimin e Buxhetit për vitin 2018, të anulosh seancën plenare të caktuar për shkak se kryeparlamentari nuk mund të siguron kuorum është papërgjegjësi e deputetëve të shumicës parlamentare dhe njëherit kjo tregon se sa shumica parlamentare aktuale është stabile", thotë Fadil Zendeli, deputet i Lëvizjes BESA. Në anën tjetër, si arsye për dështimin e seancës plenare dhe e njëjta të caktohet

me 22 dhjetor sipas koordinatorit të LSDM-së, Tomislav Tuntev, mund të jetë dhe mbajtja e mbledhjes së përbashkët që po mbahet në qytetin e Pogradecit të Shqipërisë midis Qeverisë së Shqipërisë dhe Qeverisë së Maqedonisë.

"Edhe ne deputetët e LSDM-së u njoftuam përmes kumtesë së Parlamentit, se seanca e sodit për buxhetin anulohet, për shkak të mungesës së një numri të deputetëve të shumicës parlamentare dhe në të njëjtën kohë kur dhe është caktuar seanca plenare për buxhetin e vitin 2018, në Pogradec të Shqipërisë, mbahet seanca e përbashkët midis Qeverisë shqiptare dhe Qeverisë së Maqedonisë", tha Tuntev, koordinatori i partisë LSDM. Si arsye tjetër, Tuntev e potencoi faktin se me shtyrjen e

seancës edhe për një javë, ju jepet shans deputetëve të VMRO, të kthehen në seancë plenare dhe të zhvillojmë debat konstruktiv rreth propozim buxhetit për vitin 2017. "Nuk ka logjikë të zhvillohet debat gjatë pese ditëve të ardhshme, kur në sallë nuk janë të pranishëm deputetët e opozitës. Nëse deputetët e VMRO-së ndryshojnë mendje dhe kthehen në Kuvend, atëherë në seancën e caktuar më 22 dhjetor, do të zhvillojmë debat gjatë pesë ditëve të ardhshme dhe me 24 dhjetor do të miratojmë buxhetin. Nëse edhe më 22 dhjetor deputetët e VMRO-së e bojkotojnë seancën plenare, atëherë ka gjasa që propozim buxheti për vitin 2018 të miratohet me 22 dhjetor", tha Tomislav Tuntev, koordinatori i partisë në pozitë LSDM. (Z.V.)

DEBATI PËRFUNDOI PA ASNJË AMENDAMENT

Ligji për gjuhët nuk ndryshohet

Shkup, 15 dhjetor – Komisioni për çështje evropiane dhe Komisioni juridiko-ligjdhënës para mesnaten mbrëmë e përfundoi debatin e amendamenteve për Propozim-ligjin për përdorim të gjuhëve. Në Komisionin për çështje evropiane nuk u votua për asnjërin nga 90 amendamentet e dorëzuara. Në kumtesë nga Komisioni thuhet se në pajtueshmëri të nenit 171-v paragrafi 1 nga Rregullorja e Kuvendit, Komisioni nuk arriti të prononcohet për amendamentin e parë. Në pajtueshmëri me Rregulloren, siç thuhet, Komisioni për çështje evropiane nuk zhvilloi debat edhe për amendamentet e tjera të dorëzuara për shkak se skadoi afati prej më së shumti tre ditë pune për zhvillim të debatit për amendamentet. Seanca është mbyllur pa u pranuar asnjë nga 90 të dorëzuarit prej të cilëve 84 nga VMRO-DPM-



NE-ja, katër nga LSDM-ja dhe dy nga Besa. Ligji është përcjellë deri te Kuvendi. Kryetari i Komisionit Artan Grubi në deklaratë për mediat dje tha se ai nuk mund t'i kufizojë deputetët në gjatësinë e fjalimeve të tyre dhe i hodhi poshtë pohimet se ky është një lloj bllokimi që të pengohet debati për

amendamentet e dorëzuara nga Besa, LSDM-ja dhe VMRO-DPM-NE-ja. BDI-ja, siç tha, nuk mbështet ndryshim të tekstit të ligjit, i cili është prodhim i kompromisit politik midis partnerëve të koalicionit. Në ndërkohë, Sekretariati për Implementimin e Marrëveshjes së Ohrit (SIMO) përshëndet mirati-

min e Propozim Ligjit për përdorimin e gjuhëve në lexim të dytë pa asnjë ndryshim dhe amendamentin e pranuar nga ana e Komisionit për çështje Evropiane të Parlamentit të Republikës së Maqedonisë, thuhet në kumtesën e sekretariatit. Gjithashtu, pritët që ky Propozim ligj që parasheh zyrtarizimin e gjuhës shqipe të miratohet në seancën plenare të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë. Siç thuhet në kumtesë, miratimi i Propozim ligjit për gjuhët dëshmon edhe njëherë vullnetin politik të shumicës parlamentare për zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit dhe reformave që janë të nevojshme për procesin integruar të vendit. Ky propozim-ligj është një nga kushtet që duhet të plotësohet dhe të parashihet në Planin e Qeverisë reformatore 3-6-9 për integrimin e vendit në Bashkimin Evropian.

Zaev: Me kryesimin bullgar, na hapen dyert e BE-së

Shkup, 15 dhjetor – Italia qëndron fuqishëm në qëndrimin se dyert e BE-së dhe të NATO-s hapen edhe për Republikën e Maqedonisë dhe për shkak të përcaktimit kryesor të theksuar të Bullgarisë si kryesues i ardhshëm i BE-së, vendet e Ballkanit Perëndimor, duke e përfshirë edhe Maqedoninë, të jenë në prioritetet e zgjerimit të ardhshëm të Unionit, i konkretizuan kryeministrit Zoran Zaevit, përfaqësuesit e Senatit italian. Italia është për integrimin e Ballkanit Perëndimor në BE dhe mbetet afirmuese e fuqishme dhe mbështetëse e qëllimeve strategjike të Maqedonisë - anëtarësimin në BE dhe në NATO, u tha në takim në Qeveri. Siç kumtoi shërbimi qeveritar për media, delegacionin e Senatit italian e kryesoi kryetari i Komisionit të senatit për politika të BE-së Vanino Kiti, ndërsa në takim mori pjesë edhe ambasadori Karlo Romeo. "E përshëndesim mbështetjen e vazhdueshme të Italisë për Maqedoninë dhe për integrimin e Ballkanit Perëndimor në BE. Për Maqedoninë është shumë e rëndësishme miqësi shumëvjeçare dhe e sinqertë me Republikën e Italisë. Kjo veçanërisht do të theksohet me mbështetjen në periudhën e pavarësisë dhe në të gjitha fazat kyçe të procesit të integrimi euro-atlantike të vendit tonë", tha kryeministri. Gjatë bisedës u potencua se kontaktet janë shumë të rëndësishme midis Kuvendit të Maqedonisë dhe dy dhomat e Parlamentit italian, veçanërisht për aspiratat e vendit tonë për anëtarësim në NATO dhe BE. Interes i përbashkët i dy vendeve, nënvizuan bashkëbiseduesit, është edhe zhvillimi i Korridorit 8 si një prej projekteve kyçe nga Samiti i sivistëm në Trieste. "Bashkëpunimi i sinqertë dhe besimi i përbashkët në nivel të lartë jep rezultate edhe në bashkëpunimin ekonomik. Këtë e konfirmon fakti se Italia është midis pesë partnerëve më të rëndësishëm ekonomik dhe tregtar të Maqedonisë", theksoi kryeministri Zoran Zaev.

RAPORT I IDNJ-SË PËR KËSHILLIN GJYQËSOR



ZGJEDHJET E GJYKATËSVE NUK ARSYETOHEN

Vërejtjet tjera e theksuar në raportin e fundit të IDNJ, lidhet me procedurat në të cilët punohet për shkarkimin e gjykatësve (gjatë kësaj periudhës apo brenda viteve të kaluara janë shkarkuar shumë gjykatës), të cilët procedurat e përfunduara në Maqedoni i kanë denoncuar para Gjykatës së Strasburgut

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 15 dhjetor - Për dallim nga vitet e kaluara, transparenca e Këshillit Gjyqësor është rritur, megjithatë respektimi i këtij parimi themelor të demokracisë edhe nuk zbatohet në pajtim me dokumentet ndërkombëtare. Kryetarja e Institutit për të Drejtat e Njeriut, Margarita Caca Nikolovska, këtë konstatim e shpalosi gjatë publikimit të raportit të fundit për këtë vit, për punë dhe aktivitetet e Këshillit Gjyqësor të Maqedonisë.

Llogaridhënia dhe transparenca e këtij organi të rëndësishëm për rritjen e besueshmërisë në sistemin gjyqësor, siç tha juristja Nikolovska, kryesisht mungon në kohë kur duhet të jepen sqarime për vendime se pse një gjykatës është zgjedhur dhe një tjetër jo. Kjo çështje, sipas saj, vlen edhe për vetë gjykatësit, të cilët mund të mos pajtohen me zgjedhjen, mirëpo thjeshtë nuk e kanë të qartë (nëse i plotësojnë kushtet) pse nuk janë zgjedhur. Vërejtjet tjera të theksuara në raportin e fundit të IDNJ, lidhet me procedurat në të cilët punohet për shkarkimin e gjykatësve (gjatë kësaj periudhës apo brenda viteve të kaluara janë shkarkuar shumë gjykatës), të cilët procedurat e përfunduara në Maqedoni i kanë denoncuar para Gjykatës së Strasburgut. Gjatë shqyrtimit të këtyre lëndëve, mes tjerash, kjo gjykatë ka zbuluar se njëra prej arsyeve se pse ka ardhur deri te kjo situatë, lidhet pikërisht me mungesën e transparencës dhe llogaridhënies.

"Pavarësia e sistemit gjyqësor është

çështje tjetër, por edhe ajo ka lidhshmëri me këto elemente. Nuk mund ne të kemi gjyqësor të pavarur, nëse në pjesën e përzgjedhjes dhe shkarkimit të gjykatësve, nuk ka transparencë dhe llogari të organeve që e kryejnë këtë funksion. Në të gjithë këtë situatë, më e rëndësishme është se nuk ekziston asnjë lloj përgjegjësie për mos llogaridhënie apo transparencë, respektivisht përgjegjësi mungon për të gjitha veprimet e atyre organeve që merren me shkarkim dhe përzgjedhje të gjykatësve. Shpresoj se me ndryshimet e fundit të Ligjit për Këshillin Gjyqësor dhe Ligjin për gjykata, këto probleme do të tejkalohen, me çka në këtë drejtim do të vendosen disa obligimi më të rrepta ligjore", tha Nikolovska. Në komentin e saj për zhvillimet dhe ngjarjet e fundit që ndodhën në Këshillin Gjyqësor, ajo nënvizoi se institucioni në fjalë, në të kaluarën, votimin e gjykatësve, kryesisht e ka realizuar përmes shtypjes së një pulle dhe nuk ka pasur asnjë far komenti rreth pikëve, të cilat i kanë fituar gjykatësit, apo për rrethanat tjera. Mbledhja e pikëve nga azhurnimi i lëndëve apo efikasiteti në procedimin e tyre, sipas kryetares së IDNJ-së, duhet të bëhet me dallimin e pikëve kur flitet për gjykatat e shkallës së parë dhe atyre që kanë të bëjnë gjykatat më të larta. "Në praktikë, pikët për gjykatat e shkallës së parë i jep Akademia për Gjykatës dhe Prokuror Publik dhe Këshilli Gjyqësor ishte i obliguar, varësisht prej pikëve, të bëjë edhe përzgjedhjen e gjykatësve të rinj apo kryetarëve të gjykatave. Për mua kjo nuk

ka paraqitur zgjedhje, por në një farë mënyrë emërim i lidhur kryesisht me pikët. Ne dhe dokumentet ndërkombëtare kemi qasje të ndryshme sa i përket pikave, dhe shpresoj se tutje vetë dhënia e pikave do të jetë më thelbësore, ku aktiviteti dhe puna e plotë e gjykatësve do të dalë në shesh", theksoi Nikolovska.

Përzgjedhja e fundit e gjykatësve nga Këshilli Gjyqësor, u realizuar me prezantimin e elementeve tjera dhe u miratuan vendimet e njohura. Megjithatë, sipas ekspertës ligjore, Këshilli nuk ka treguar se pse ai me pikët më të lartë nuk duhet të zgjidhet. Ndryshe, javë më parë, pas shpalljes së konkursit për zgjedhjen e dy gjykatësve për Gjykatën Supreme, katër gjykatësve për Gjykatën e Apelit dhe një gjykatës për Gjykatën e Apelit në Manastir, Këshilli Gjyqësor me shumicë votash, në vend të shtatë gjykatësve, zgjodhi vetëm pesë. Kështu që për Gjykatën e Supreme u zgjodh vetëm një gjykatës, për atë të Apelit në Shkup, u zgjodhën vetëm tre gjykatës dhe për gjykatën e Apelit në Manastir, u zgjodh gjykatësi i vetëm.

Bastiset Kançevska dhe Bozhinovski

Shkup, 15 dhjetor - Me urdhër të Prokurorisë Speciale Publike, mëngjesin e ditës së premte policia ka bastisur shtëpitë e ish-funksionarëve të lartë të pushtetit të kaluar, gjegjësisht shtëpinë e ish-ministres së Kulturës, Elizabeta Kançevska-Milevska dhe ish-sekretarit të Qeverisë, Kiril Bozhinovskit. Dy anëtarët e VMRO-DPMNE-së, nga PSP ngarkohen për kryerje të veprës penale "keqpërdorim të detyrës dhe autorizimeve zyrtare". Ish-ministria Kançevska, sipas propozim-akuzës së parashtruar nga PSP në fund të qer-

shorit, qëndron si e dyshuara kryesore në rastin "Tenderat". Gjithnjë sipas akuzave të PSP-së, tre të akuzuarit në rastin "Tenderat", mes tyre edhe Kançevska-Milevska, dyshohen për keqpërdorime me furnizimet publike gjatë kohës së ndërtimit të muzeut të VMRO-së në Shkup. Nga ana tjetër, ish-sekretari i Qeverisë, Bozhinovski nga PSP dyshohet se ka kryer veprën penale "për prishje të rendit zgjedhor", respektivisht ai dhe 22 të akuzuar tjerë pritet të gjykohen për lëndën gjyqësor "Titanik". Mes tjerash, pjesë e kësaj aktaku-



ze janë edhe Nikolla Gruevski e Gordana Jankulovska. Të dy rastet e apostrofuara, siç kanë njoftuar nga PSP, kanë ndodhur brenda vitit 2011. (O.XH)

KRONIKË

Vidhet ari dhe bizhuteri në Gostivar

Persona të panjohur të enjten kanë kryer vjedhje të rëndë në shtëpinë e 45 vjeçarit F.J në rrugën Nikola Parapunov në Gostivar. Sipas policisë, pasi që me forcë kanë hapur dritaren e katit përdhës, ata kanë hyrë brenda dhe kanë marrë lloje të ndryshme të arit dhe më pas janë larguar në drejtim të panjohur. Gjithsej vlera e arit dhe bizhuterisë së vjedhur është përlogaritur 180 mijë denarë. Janë marrë masa për zbardhjen e plotë të kësaj vjedhje.

Aksident afër Çellopekut

Në rrugën regjionale Tetovë-Vollkovijë, në afërsi të kthesës për në fshatin Çellopek, mëngjesin e ditës së premte veturë e tipit Audi A4, me targa të Tetovës, ka humbur kontrollin dhe ka dalë nga rruga. Me këtë rast, vozitësi L.A, 34 vjeçar nga fshati Stençe dhe katër bashkudhëtarë, R.P 42 vjeçar, M.B 31 vjeçar, A.N 27 vjeçar dhe V.A 55 vjeçar, që të gjithë nga fshati Stençe, kanë marrë lëndime trupore dhe janë dërguar në Spitalin Klinik të Tetovës, kurse një nga bashkudhëtarët për shkak të lëndimeve serioze, është dërguar në Klinikat e Shkupit.

Përdhunim në Vinicë

Policia dje ka marrë informacion për dhunim të një minorene 16-të vjeçare në stadiumin e qytetit në Vinicë. Në orët e paradites në Vinicë në stadiumin e qytetit U.Q (18) nga Vinica ka kryer veprën penale "përdhunim" mbi një minorene 16-të vjeçare, njoftoi policia. Ekspertizë në vendin e ngjarjes ka kryer ekipi i SP-Koçan, Me urdhër të Prokurorit Publik, U.Q është privuar nga liria dhe mbajtur në SP-Vinicë. Pas zbardhjes së tërësishme dhe dokumentimit të rastit do të parashtrohet padi përkatëse.

Sulmohet një 15-vjeçar në një autobus të NPT-së

Disa persona të panjohur në moshë prej 15 deri 18 vjeç fizikisht kanë sulmuar një djalë 15-vjeçar në autobusin e NPT nr.65 i cili ka qarkulluar nga fshati Stajkovc deri te Qendra Transportuese - Shkup. Nëna e djalit E.N (36) në polici e ka paraqitur sulmin që ka ndodhur rreth orës 13:20 kur në fshatin Hasanbeg në autobus kanë hyrë disa persona të panjohur të cilët pasi janë ngjitur në katin e sipërm fillimisht e kanë sulmuar të miturin, e pastaj edhe shokët e tij. Djali ka marrë lëndime dhe në Spitalin e Përgjithshëm të Qytetit "Shën Naumi i Ohrit" i është dhënë ndihmë mjekësore. Ndërmerren masa për zbardhje të tërësishme të rastit.

Zbulohet një bastore ilegale në Gradec

Gjatë kontrollit të policisë, në qendrën e fshatit Gradec të Gostivarit, dje është zbuluar një bastore e cila ka punuar ilegalisht, informojnë nga SPB Tetovë. Zëdhënësi Marjan Josifovski thotë se nëpunës policorë të SPB Tetovë-Stacioni policor Gostivar, dje rreth orës 14 kanë kryer kontroll në një bastore sportive, në të cilën ilegalisht janë organizuar lojëra të fatit dhe bixhoz. Në objekt është gjetur A.XH. (25) si i punësuar. "Në objektin pa firmë, janë gjetur dhe janë konfiskuar: nëntë televizorë, gjashtë poker aparate me 13 çelësa, tre kasa kompjuterike, dy monitorë, katër printerë, një tastaturë, katër buletinë, katër tiketa dhe të holla në vlerë të përgjithshme prej 81.690 denarësh", thotë Josifovski. Në vijim janë aktivitetet për zbardhjen e të gjitha detajeve, me ç'rast kundër pronarit të basteres do të pasojë parashtrësë adekuate. (U.H)

TURIZMI MALOR

KODRA E DIELLIT

PRET DECENTRALIZIMIN!



Hapi i parë për kalimin e potencialit ekonomik që posedon Kodra e Diellit në mundësi reale për zhvillim, si qendër numër një dimërore në Maqedoni dhe hapjen e mijëra vendeve të reja të punës, është kalimi i kompetencave nga pushteti qendror te pushteti lokal

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 15 dhjetor - Me dekada të tëra flitet për potencialin e madh turistik dhe zhvillimin e Kodrës së Diellit në qendër të madhe dhe moderne të sporteve dimërore. Megjithatë, të gjitha planet për zhvillimin e saj, si duket kanë mbetur në letër, përderisa në të njëjtën kohë qendrat rajonale si Bansko apo Kopaoniku janë shndërruar në perla të vërteta të turizmit ku në sezon as që mund të gjendet vend i lirë. Eksperti i turizmit Mislim Zendeli, thotë se çështja e padefinuar e pronësisë së Kodrës së Diellit mbetet pengesa kryesore për zhvillimin e saj. Andaj, sipas tij, hapi i parë dhe kryesor për kalimin e potencialit ekonomik që posedon Kodra e Diellit në mundësi reale për zhvillim, si qendër numër një në

Maqedoni dhe më gjerë me hapjen qindra, por edhe mijëra vendeve të reja të punës, është kalimi i kompetencave nga pushteti qendror në kompetencat e pushtetit lokal të kësaj pike turistike. "Zhvillimi i Kodrës së Diellit, për të cilin flitet vite i e vite, në radhë të parë është çështje e pazgjidhur politike lidhur me vonesën e një decentralizimi të vërtetë në vend dhe pastaj është çështje ekonomike. Si mundet që të gjithë fshatrat përreth Kodrës së Diellit t'i takojnë Komunës së Tetovës, ndërsa vetëm kjo qendër turistike t'i takojë pushtetit qendror. Andaj, nevojitet kjo çështje të ngrihet dhe zgjidhet në Kuvendin e Maqedonisë, me qëllim që Komuna e Tetovës të ketë kompetenca të plota lidhur me zhvillimin e saj dhe më pastaj të intensifikohen punët lidhur me

modernizimin e Kodrës së Diellit", thotë specialisti i fushës së turizmit dhe profesori universitar, Mislim Zendeli.

Sipas tij, hapi i dytë më tej, pas fitimit të kompetencave, do të ishte gjetja e një investitori të huaj përmes sistemit të partneritetit private-publik, që do të mundësojë zhvillim të qëndrueshëm të kësaj pike turistike, duke e ruajtur atë edhe për gjeneratat e ardhshme dhe jo duke e shkatërruar në mënyra të ndryshme jo vetëm në aspektin ekologjik.

"Pra, Komuna, pas fitimit të kompetencave duhet të përgatisë një plan të posaçëm për zhvillimin e Kodrës së Diellit, në bashkëpunim me punëtorët shkencor, ku do të dihet saktësisht se si do të zhvillohet ajo, duke filluar nga përfshirja maksimale e komunitetit lokal në punësimet e ardhsh-

me në këtë zonë, zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm dhe jo masovik, me përkufizimin e numrit të vizitorëve, zgjatjen e punës së saj në të katër stinët, zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit, përveç atij dimëror si alpinizmi, çiklizmi, paraglajding e kështu me radhë", thekson më tej Zendeli. Ai vlerëson se turizmi në botën moderne, është një nga degët ekonomike që sjell më shumë të ardhura ekonomike për një shtet, për shkak se realizon një eksport të padukshëm. Gjithashtu turizmi modern malor zhvillon më shumë veprimtari si hotelet, bujqësia, blegtoaria, ndërtimtaria, përgjatë 12 muajve të vitit dhe jo vetëm për katër muaj. Ndryshe, punëtorët e turizmit, thonë se gjatë ringjalljes së Kodrës së Diellit, si perlë e turizmit malor në Ballkan, duhet marrë parasysh se ai ky

vend turistik, patjetër të zhvillohet përgjatë tërë vitit, për çka ekzistojnë kushte ideale natyrore, si burimet e ndryshme, ujëvarat, liqenet malore etj. për shkak se ekzistojnë një numër i konsiderueshëm i turistëve që nuk durojnë diellin, andaj më shumë preferojnë pushimin në mal. Për këtë qëllim, nevojitet të krijohen edhe kushte për pushim, rekreim, zbatimje natën, kuzhinë cilësore, lloje të ndryshme rekreimi, si për shembull qendrat spa me pishina dhe përmbajtje të tjera atraktive. Ndryshe, ofertat jociësore e qendrave vendore të skijimit si Kodra e Diellit, por edhe mungesa e infrastrukturës së duhur për zhvillimin e turizmit malor, i kanë drejtuar turistët e huaj drejt qendrave moderne dimërore të fqinjëve, në vend të frekuentimit të qendrave vendore.

MINISTRIA E KULTURËS DO RISHIKOJË VENDIMIN

KINEASTËT NË PROTESTA, KËRKOJNË RRITJEN E BUXHETIT

Në një protestë të organizuar të premtën përpara Ministrisë, ata kanë kërkuar rishikimin e këtij vendimi, sa i takon buxhetit të Agjencisë, si edhe financimit në përgjithësi të veprimtarisë kinematografike

Koha Evis HALILI

Shkup, 15 dhjetor - Vendimi i Ministrisë së Kulturës për të reduktuar buxhetin e vitit të ardhshëm të Agjencisë së Filmit ka hasur në reagimin e punonjësve të filmit, kinëastëve, producentëve. Në një

protestë të organizuar të premtën përpara ministrisë ata kanë kërkuar rishikimin e këtij vendimi, sa i takon buxhetit të Agjencisë, si edhe financimit në përgjithësi të veprimtarisë kinematografike. Kjo protestë e paralajmëruar ka detyruar këtë institucion të ndryshojë qëndrimin sa i takon masave të marra për të "ndëshkuar" financiarisht Agjencinë e Filmit. Për shkak të borxheve dhe abuzimeve financiare të konstatuara të agjencisë me disa projekte të përzbuluara filmime, mes të cilave seriali "Maqedonia".

"Reduktimi i buxhetit që i dedikohet filmit në kohën kur buxheti shtetit rritet është një goditje direkte për produksionin filmik, që edhe ashtu është i brishtë. Argumentet se edhe me më pak para

bëhen filma të mirë janë të vërteta, por si përjashtim. Argumentet se janë dhënë para dhe janë realizuar filma të këqij janë po ashtu ta sakta, por vlejnë për kohë të tjera, kur jepeshin me vendime politike, gjë për të cilën kanë luftuar pjesa jonë më e madhe. Prandaj ju lusim që të rishikoni vendimin...", thuhet në letrën e lexuar nga përfaqësuesit e punonjësve të filmit. Ata po ashtu kanë kërkuar një takim me përfaqësues të ministrisë, qeverisë, punonjësve të pavarur të filmit dhe Agjencisë se filmit për të rishikuar vendimin. Këshilltari i ministrit të Kulturës, Petrit Saraçini, duke iu drejtuar protestuesve të mbledhur ka thënë se janë pikërisht borxhet që e kanë detyruar ministrinë që të reduktojnë buxhetin si një metodë për të

likuiduar minusin, por jo në dëm të realizimit të projekteve. Ai ka kërkuar prej tyre që të propozojnë buxhete reale, brenda kornizave të shpenzimeve për produksionet, por edhe në përputhje me standardin aktual të jetesës. "Angazhimi ynë është që të ndihmojmë dhe mbështesin të gjitha projektet cilësore. Jemi të gatshëm, që në rast se do të na ofrohen projekte të tilla të sigurojmë fonde, si përmes ride-dikimit, ashtu edhe nga rebalanci i buxhetit. Qëllimi ynë nuk është që të ndahen mjete financiare dhe ato të përfundojnë në formë jo-produktive në xhirollogaritë e institucioneve, por të shpenzohen sipas dinamikës së kërkuar. Nëse do t'na ofrohen projekte të tilla ne do t'i mbështesim me kënaqësi dhe jemi të gatshëm që në atë drejtim

të rrisim buxhetin. Gjithësi në interes të qytetarëve, dhe pasi që bëhet fjalë për shuma të konsiderueshme, të vendosim kritere më të larta për përzgjedhjen e projekteve...", ka thënë këshilltari Saraçini. Sipas tij, fondi i akorduar për Agjencinë e filmit është projektuar i tillë që të përmbushë nevojat e punonjësve, por edhe pse më i vogël nuk është si buxhetet e akorduara nga qeveria e mëparshme që janë përdorur për të prodhuar propagandë politike dhe partiake, dhe jo vepra artistike. Në buxhetin e vitit 2018, të prezantuar pak ditë më parë nga ministri i kulturës, Robert Allagjovovski, buxheti për Agjencinë e Filmit është 154.5 milionë denarë, ose rreth 4 % e buxhetit të përgjithshëm për financimin e veprimtarive të kulturës.

SHPALLJE ME ÇMIME ABSURDE

FITOJNË TENDERË EDHE ATA ME 0.01 DENARË

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 15 dhjetor - Në Maqedoni realizohen tenderë edhe me çmime absurde prej 0.01 denarë. Sipas raportit të fundit të Qendrës për Komunikime Qytetare, që ka ndjekur furnizimet publike për periudhën janar-qershor 2017, çmimi më i ulët si kriter i vetëm për zgjidhje, na shpjen ndaj tenderëve me çmime absurde prej 0.01 denarë dhe 0.01 për qind. Jologjikshmëritë e tilla të tregut vetëm e rrisin rrezikun nga manipulimet e mundshme në realizimin e tenderit shton më tej raportit.

"Në tenderët që ishin lëndë e monitorimit në gjysmën e parë të 2017-ës, marrëveshjet e shërbimeve për 0.01 denarë, ishin nënshkruar për furnizimin me shërbimin e operatorit celular, dhe për shërbimin e agjencisë së marketingut për përkrahje të marketingut, ndërsa çmimi prej 0.01 për qind i shërbimit ishte për angazhimin e agjencisë autoriale, përmes së cilës do të realizohet pagesa e kompensimeve të autorit. Njëherazi, në furnizimin e shërbimit të operatorit celular, çmimi prej 0.01 denarë nga operatori celular, është fituar për një minutë bisedë ndaj rrjetit vetanak, ndaj rrjeteve të tjera celulare dhe fikse pas tejkallimit të minutave falas të përfshira në pakot e parashikuara", shton më tej raportit.

Analiza e Qendrës për Komunikime Qytetare që në vitet e kaluara në vazhdimësi nxjerr në shesh, anomali, dobësitë dhe problemet e ndryshme të tenderëve në Maqedoni, thekson më tej se kompanitë që kanë konkurruar në këtë tender, vetëm kanë ndjekur rregullat e lojës.

"Oferta është e dorëzuar nga dy operatorë celularë pas dorëzimit fillestar të ofertave. Njëherazi, të dy ofertuesit kanë dhënë çmimin më të ulët të mundshëm, duke pasur parasysh se në dokumentacionin e tenderit për furnizim është theksuar se "Çmimi i ofruar, që do të jetë lëndë e ankandit elektronik, nuk guxon të ketë më shumë se dy decimale, ndërsa çmimi më i ulët i mundshëm në listë pa TVSH është 0.01 denarë. Çdo ofertë që nuk do t'i përmbushë këto kushte, do të hidhet poshtë si e papranueshme", thekson më tej raportit.

Nga ana tjetër, analizë e Qendrës për Komunikime Qytetare, e një pjesë të tenderëve e tregon se gjatë ankandit elektronik arrihen çmime aq të ulëta, sa që vendoset në pikëpyetje realiteti i vlerësimit të vlerës së tenderëve si dhe cilësia e furnizimeve. Andaj, në të ardhmen sugjerohet anulimi i zgjidhjes së tanishme ligjore, sipas së cilës i vetmi kriter për ndarjen e marrëveshjes

është "çmimi më i lirë". Zgjidhja e re ligjore duhet të bazohet në konceptin e "Ofertës më të volitshme ekonomike", që bazohet në Direktivën e re evropiane të vitit 2014.

Në ndërkohë, ndër vërejtjet tjera të monitorimit të furnizimeve publike, janë edhe ato se bile në 35 për qind të tenderëve të monitoruar, ekziston hedhje poshtë e ofertave, për shkak se janë cilësuar si të papranueshme. Një për qindje kaq e lartë e tenderëve të dështuar në mënyrë shtesë e përkeqëson konkurrencën e tyre, thekson raportit.

Në gjysmën e parë në vitin 2017, deri tek Këshilli për furnizime publike janë dorëzuar 7.583 kërkesa nga palët kontraktuese, ose vetëm 9 për qind më pak se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Gjithashtu, në gjashtë muajt e parë të vitit, përmes procedurës jo-transparente të negociimit dhe pa publikimin e shpalljes, janë nënshkruar marrëveshje në vlerë prej 7.4 milionë euro, që është për 12 për qind më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në rritje e sipër, është edhe anulimi i tenderëve. Në periudhën janar-qershor të këtij viti janë anuluar 2033 tenderë në mënyrë të tërësishme apo të pjesshme, që paraqet një pjesëmarrje prej 23 për qind në totalin e shpalljeve të publikuara në këtë periudhë.

Ndryshe, në fillim të muajit të kaluar, Kuvendi i Maqedonisë, i miratoi ndryshimet e Ligjit për furnizi-

Analiza e Qendrës për Komunikime Qytetare për një pjesë të tenderëve, tregon se gjatë ankandit elektronik arrihen çmime aq të ulëta, sa që vendoset në pikëpyetje realiteti i vlerësimit të vlerës së tenderëve si dhe cilësia e furnizimeve



Në gjashtë muajt e parë të vitit, përmes procedurës jo-transparente të negociimit dhe pa publikimin e shpalljes, janë nënshkruar marrëveshje në vlerë prej 7.4 milionë euro, që është për 12 për qind më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në rritje e sipër, është edhe anulimi i tenderëve. Në periudhën janar-qershor të këtij viti janë anuluar 2033 tenderë në mënyrë të tërësishme apo të pjesshme, që paraqet një pjesëmarrje prej 23 për qind në totalin e shpalljeve të publikuara në këtë periudhë

me publike, me të cilat më nuk do të ekzistojë Këshilli për furnizime publike. Në vend se të kontribuojë për rritjen e transparencës në procedurat e furnizimeve publike, ky organ sipas qeverisë, ka ndikuar negativisht në efikasitetin e sistemit dhe atë më së shpeshti përmes bllokimit të institucioneve, prolongimit të procedurave dhe rritjes së harxhimeve. Opozita vlerësoi se nuk duhet nxituar me një lëvizje të tillë, për shkak se Ligji i ri për furnizime publike paralajmërohet për në tetor të vitit të ardhshëm, andaj për opozitën mbetet çështje e hapur se kush do të kontrollojë në ndërkohë procedurat e furnizimeve publike.

Maqedonia kryeson me Komunitetin energjetik

Prishtinë, 15 dhjetor - Në takimin në Këshillin ministror të Komunitetit Energjetik, ministri i Ekonomisë Kreshnik Bekteshi i ka theksuar prioritetet gjatë kryesimit të Maqedonisë siç janë bashkëpunimi rajonal në raste urgjente për energjinë elektrike me qëllim që të shmangen ndalesat e njëanshme për eksport, si dhe zgjidhjen e kontesteve rajonale në suaza të Komunitetit Energjetik. "Në takimin në Këshillin ministror, ministri Bekteshi e ndërmori kryesimin me Komunitetin Energjetik për vitin e ardhshëm, më saktë për periudhën nga 1 janari e deri më 31 dhjetor të vitit 2018, ndërsa para Këshillit të ministrave i theksoi prioritetet gjatë kryesimit të Maqedonisë, në mesin e të cilave plotësimin e Marrëveshjes për themelimin e Komunitetit Energjetik, zbatimin e plotë të Pakos së tretë energjetike, veçanërisht ndarjen e operatorëve të sistemeve të transmetimit, energjisë elektrike dhe gazit tek të gjitha palët kontraktuese, zbatimin e Memorandumit rajonal për mirëkuptim të dakorduar në WB6 për bashkim një ditë më herët tregjet e energjisë elektrike dhe balancimit, vendosjen e rregullave të barabarta për lëshimin dhe njohjen e licencave dhe të ngjashme", theksohet në kumtesën e Ministrisë së Ekonomisë. Takimet në Këshillin ministror mbahen një herë në vit edhe atë në vendin që do ta caktojë vendi nënshkruar në Marrëveshjes që atë periudhë kryeson me Komunitetin Energjetik, konform parimit të rotacionit.

SHKUPI VAZHDON TË JETË MË I NDOTURI

Shkup, 15 dhjetor - Pasditën e sotme pritet pastrim i mjegullës dhe ndotjes në Shkup. Nga DPHM-ja paralajmërojnë se rreth mesditës dhe pasditës do të fillojë të fryjë erë e cila do të kontribuojë për pastrim të mjegullës dhe ndotjes, ndërsa nga nesër do të ketë edhe reshje shiu. Niveli i PM10 grimcave gjatë natës së kaluar në Qendër nuk janë lëshuar nën 200 mikrogramë. Vlerat maksimale i ka arri-

tur gjatë natës kur janë matur deri në 470 mikrogramë në një metër kub. Mëngjesin e sotëm matjet e fundit tregojnë koncentrimet nga 277 mikrogramë. Në Gazi Babë niveli i PM10 grimcave lëvizte nga 90 deri në 560 mikrogramë. Ndotje më të madhe ka pasur gjatë natës, ndërsa në mëngjes në orën 9 janë matur 184 mikrogramë. Në Karposh nga 199 deri në 625 mikrogramë. Në mëngjes

matjet tregojnë koncentrimet disa herë më të larta dhe në orën nëntë ishin 261. Në Lisiçe koncentrimet kanë lëvizur nga 177 deri në 454 mikrogramë. Gjatë natës ka pasur më shumë ndotje, ndërsa në mëngjes vërehet ulje dhe në orën nëntë janë matur 181 mikrogramë në një metër kub. Tek Rektorati stacionet matëse kanë regjistruar koncentrimet të PM10 grimcave nga 222 deri në 638 mikrogramë.



Nga ora 20 deri në orën 22 ndotje më të mëdha janë matur nga 610

deri në 634 mikrogramë në një metër kub.


AGJENCIA PËRKRAHJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Në bazë të nenit 7, alineja 9 e Ligjit për themelimin të Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Maqedonisë numër 72/2007, 5/2009, 43/2014, 193/2015 dhe 39/2016), Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural në vijim publikon

THIRRJE PUBLIKE nr. 04/2017
Për dorëzimin e kërkesave për pagesë të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2017
I. LËNDA E SHPALLJES

Lëndë e kësaj shpallje është ndarje e përkrahjes financiare për masat në vijim:

Grupi masave	Ndihmë për mbrojtjen e rajoneve rurale dhe karakteristikat e tyre tradicionale	Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme (deri më)
Masa 213	<p>Kompensimi i shpenzimeve për mirëmbajtjen e kullosave të vendeve malore dhe livadheve dhe përkrahje e blegtorisë tradicionale</p> <p>- në shumë prej 100% nga neto pagesa mujore mesatare në veprimtari të periudhës prej 01.11.2016 deri më 31.10.2017, si shpenzime për ruajtjen dhe kullotjen e bagëtisë (dhen, dhi dhe/ose lopë) në kullosa (duke përfshirë edhe livadhet) që gjenden në vendet e banuara me lartësi mbidetare më të lartë se 700 metra, gjegjësisht vendet e regjistruara për ruajtje ku ruhet bagëtia të gjenden në vendbanime me lartësi mbidetare më të lartë se 700 metra dhe</p> <p>- në shumë prej 60% nga bruto pagesa mujore në veprimtari të periudhës prej 01.11.2016 deri më 31.10.2017, si shpenzime për ruajtje dhe kullotje të bagëtisë (dhen, dhi dhe/ose lopë) që gjenden në vendet e banuara me lartësi mbidetare nën 700 metra, gjegjësisht vendet e regjistruara për ruajtje ku ruhet bagëtia të gjenden në vendbanime me lartësi mbidetare më të lartë se 700 metra</p>	<p>- Jo më shumë se 300.000 denarë për person të punësuar për jo më shumë se 20 persona të punësuar</p> <p>- Për mbi 10 persona të punësuar ndihma zvogëlohet për 50%</p>
Kriteret	<p>- Përkrahja ndahet në raport me:</p> <p>- 1 person të punësuar për 150 dhen</p> <p>- 1 person të punësuar për 50 dhi</p> <p>- 1 person të punësuar për 80 lopë</p> <p>Numri i personave të punësuar për të cilët paguhet përkrahja duhet të jetë i njëjtë në periudhë prej së paku një vit para vitit për të cilin është lejuar dhe paguar përkrahja</p>	

II. TË DREJTË PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE

Të drejtë për shfrytëzim të mjeteve kanë subjektet në vijim:

Subjektet	Masa
Ekonomitë bujqësore të regjistruara në pajtim me Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural në Regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore pranë Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave	213

III. KUSHTET PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI I CILI DUHET TË DORËZOHET

Kërkesat për masë të veçantë dorëzohen në kopje origjinale.

Kushtet të cilat duhet të plotësojnë kërkesit e mjeteve janë të përcaktuara me:

- Programin për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2017 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 192/2016, 07/2017, 44/2017, 100/2017 dhe 166/2017)
- Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 49/2010, 53/2011, 126/2012, 15/2013, 69/2013, 106/2013, 177/2014, 25/2015, 73/2015, 83/2015, 154/2015, 11/2016, 53/2016 dhe 120/2016)

Nëse deri në Agjenci dorëzohen më shumë kërkesa sesa ka mjete të disponueshme për masën 213, në pajtim me Programin për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2017, Agjencia do t'ju japë përparësi atyre kërkesave të cilët kanë dorëzuar kërkesën e tyre më herët se të tjerët.

Një kërkesë mund të dorëzojë një kërkesë vetëm për një masë. Një kërkesë mund të shtrojë më së shumti 2 kërkesa veç e veç për masa të ndryshme duke marrë parasysh edhe masat e tjera nga programi për zhvillim rural për vitin 2017.

IV. MARRJA E FORMULARËVE DHE UDHËZIMEVE

Formularët "Kërkesë për pagesë" me listën e dokumenteve të nevojshme mund të merret në ueb faqen e Agjencisë www.ipardpa.gov.mk.

Formularët e lartpërmendur mund të merren edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në Agjenci çdo ditë pune prej ora 8:30 deri në ora 16:30 në adresë:

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural,
Bul. "3-ta Makedonska Brigada" nr. 20
(ndërtesa e Makedonija Tabak blloku C)
1000 Shkup

V. MËNYRA E DORËZIMIT TË DOKUMENTEVE

Kërkesat e plotësuar për shfrytëzim të mjeteve dhe kërkesat për pagesë nga Programi për përkrahje financiare për zhvillim rural për vitin 2017 së bashku me dokumentacionin e tërësishëm të nevojshëm dorëzohen në gjuhën maqedonase në zarf të mbyllur me shënim në këndin e majtë lart të anës së përparme të zarfit "MOS HAP" për Thirrjen publike nr. 04/2017 dhe shënimin e shifrës së masës për të cilën dorëzohet kërkesa. Kërkesa mund të dorëzohet përmes postës ose personalisht në arkivin e Agjencisë, në të kundërtën Agjencia nuk merr përgjegjësi për arrijtjen jo në kohë ose të pakompletuar apo hapjen e parakohshme të kërkesës.

Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave është 28.12.2017. Kërkesat e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk do të merren parasysh.

Informata më të detajuara në kontakt tel. (02) 3097-460 ose në kontakt e-mail adresën: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk dhe ueb faqen: www.ipardpa.gov.mk.

Kontakt:

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, Sektori për lejm të projekteve. Dhe Sektori për lejm të pagesave.

Telefon **02 3097 - 460**, çdo ditë pune prej ora 08.30 deri në ora 16.30

e-mail: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk



Republika e Maqedonisë
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor



Drejtoria e Mjedisit Jetësor pranë Ministrisë së mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor përgatiti

Përtëritjen dhe ndryshimin e A - lejes së integruar ekologjike për Shoqatën për prodhimin e akumulatoreve TAB MAK DOO Probishtip

Koordinatat e lokacionit sipas sistemit nacional koordinativ:
464818 N 598463 E

Instalacionit bien nën aktivitete nga Shtojca 1

Pika 2.5 (a) Instalacione për prodhimin e metaleve me ngjyrë nga xehet, koncentratet ose lëndët e para sekondare me procese metalurgjike kimike ose elektrolitike.

2.5 (b) Instalacione për shkrirjen e metaleve duke i përfshirë edhe legurimin e metaleve me ngjyrë, duke i përfshirë edhe prodhimet përsëri të fituara nga (rafinimi, derdhja e t.j.) me kapacitet të shkrirjes të mbi 4 t/ ditë të plumbit dhe kadmiumit ose mbi 20 t/ ditë për të gjithë metalet e tjerë dhe e njëjta gjendet në Probishtip.

Lloji i aktivitetit:

Prodhimi i plumbit të rafinuar 24.000 (t / vit) dhe prodhimit të akumulatoreve për të gjitha llojet e automjeteve 2.250.000 copë dhe bateritë tërheqëse 1.460.000 copë në vit.

Leja do jetë e shpallur, në Ueb faqen zyrtare të Ministrisë së Mjedisit jetësor dhe planifikimit Hapësinor www.moep.gov.mk

Ankesa kundër vendimit për lejen mund të dorëzohet nga ana e personave juridik dhe fizik, si edhe nga ana e shoqatave të qytetarëve të themeluara për përparimin dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor, deri te Komisioni Shtetëror për vendimarrje në procedurën administrative dhe procedurën e marrëdhënies së punës në shkallën e dytë, **brenda 15 ditëve** nga data e publikimit të Lejes në shtypin ditor.

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 167/2015 dhe 27/2016) dhe pëlqimeve nga MASH nr. 12-9768/3, SHSHFRD Dimitar Vllahov – Shkup publikon

SHPALLJE

Për plotësim të vendeve të lira të punës për kohë të caktuar për vitin shkollor 2017/2018 edhe atë

1. Një mësimdhënës të gjeografisë për 6 orë mësimore me orar të punës prej ora 7.30, prej ditës së hënë deri ditën e premte, neto pagesa bazë 8.829,00 denarë
2. Një mësimdhënës të kimisë për 8 orë mësimore me orar të punës prej ora 7.30, prej ditës së hënë deri ditën e premte, neto pagesa bazë 7.900,00 denarë
3. Një mësimdhënës të biznesit për 4 orë mësimore me orar të punës prej ora 7.30, prej ditës së hënë deri ditën e premte, neto pagesa bazë 5.958,00 denarë.
4. Një mësimdhënës të biologjisë për 11 orë mësimore me orar të punës prej ora 7.30, prej ditës së hënë deri ditën e premte, neto pagesa bazë 13.369,00 denarë
5. Një mësimdhënës të historisë (zëvendësim për drejtorin) për 20 orë mësimore me orar të punës prej ora 7.30, prej ditës së hënë deri ditën e premte, neto pagesa bazë 18.112,00 denarë
6. Një mësimdhënës të lëndëve grafike për 16 orë mësimore me orar të punës prej ora 7.30, prej ditës së hënë deri ditën e premte, neto pagesa bazë 14.888,00 denarë.
7. Një edukator për 20 orë punë me punë në ndërrime, me neto pagesë bazë 11.829,00 denarë.
8. Një mësimdhënës të gjuhës latine për 2 orë mësimore me orar të punës prej ora 7.30, prej ditës së hënë deri ditën e premte, neto pagesa bazë 2.369,00 denarë.
9. Një mësimdhënës të lëndëve të drejtimit shëndetësor për 18 orë mësimore me orar të punës prej ora 7.30, prej ditës së hënë deri ditën e premte, neto pagesa bazë 16.677,00 denarë.
10. Një defektolog për 40 orë pune me orar të punës prej ora 7.30 prej ditës së hënë deri ditën e premte, me net pagesë bazë prej 18.901,00 denarë.

KUSHTET

Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me LMP kandidatët të cilët do të marrin pjesë duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në pajtim me Ligjin për arsim të mesëm dhe fillor (Gazeta Zyrtare nr. 52/2002)

Kandidati me numërENDOR:

1. Të ketë të mbaruar fakultetin matematiko-natyror gjeografi 7/1, me arsim njëvjeçar nga defektologjia
2. Të ketë të mbaruar fakultetin matematiko-natyror kimi 7/1, me arsim njëvjeçar nga defektologjia
3. Të ketë të mbaruar fakultetin ekonomik 7/1, me arsim njëvjeçar nga defektologjia
4. Të ketë të mbaruar fakultetin matematiko-natyror biologji 7/1, me arsim njëvjeçar nga defektologjia
5. Të ketë të mbaruar fakultetin filozofik histori 7/1, me arsim njëvjeçar nga defektologjia
6. Të ketë të mbaruar fakultetin për grafikë 7/1, me arsim njëvjeçar nga defektologjia
7. Të ketë të mbaruar fakultetin filozofik defektologji 7/1, me arsim njëvjeçar nga defektologjia
8. Të ketë të mbaruar fakultetin filozofik 7/1, me arsim njëvjeçar nga defektologjia
9. Të ketë të mbaruar fakultetin e mjekësisë Doktor i medicinës, me arsim njëvjeçar nga defektologjia
10. Të ketë të mbaruar fakultetin filozofik defektologji 7/1, me arsim njëvjeçar nga defektologjia

Kandidatët duhet t'i parashtrorin dokumentet në vijim:

- Diplomë për arsim të mbaruar ose certifikatë me provime të dhëna, dëftesë (të dorëzohen në original ose kopje të vërtetuar anë noter)
- Lutje
- Certifikatë të shtetësisë (original ose kopje të vërtetuar anë noter)
- Certifikatë për arsim njëvjeçar nga defektologjia

Afati për parashtrimin e dokumenteve është 5 ditë nga dita e publikimit të shpalljes. Vendimi për zgjedhje do të realizohet në afat prej 5 ditëve pas kalimit të afatit për paraqitje. Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit dhe i pakompletuar nuk do të merret parasysh gjatë shqyrtimit.

Dokumentet të parashtrorin në adresë SHSHFRD Dimitar Vllahov – Shkup rr. Narodni heroji nr. 8 Shkup tel. 022779 537

ANALIZAT E REJA PËR UJIN, TË MIRA

PËRMIRËSOHET CILËSIA

Nga Qendra për shëndet publik, thonë se ata qytetarë që hezitojnë të konsumojnë ujin, mund të shfrytëzojnë ujë të ambalazhuar, por shtojnë se uji në Tetovë është i pijshëm



Koha Urim HASIPI

Tetovë, 15 dhjetor - Uji nga ujësjellësi i Tetovës është i pijshëm. Të gjitha analizat e deritanishme të realizuara nga ana e Qendrës për Shëndet Publik në Tetovë, kanë treguar se uji i plotëson të gjitha kriteret dhe është i sigurt për pije. Sipas mjekëve në këtë qendër, edhe në kohën kur kishte ndryshime në shijen e ujit, parametrat kanë qenë të mira. Sipas mjekëve në Qendrën për Shëndet Publik në Tetovë, edhe analizat shtesë të bëra tregojnë se uji është i sigurt për pije në Tetovë.

"Nëse kemi informata se uji është i sigurt dhe nuk ka erë dhe shije të mirë, atëherë mund edhe të mos e konsumoni dhe të shfrytëzoni ujë të ambalazhuar, por ka edhe të atillë që nuk e ndjejnë ndryshimin e shijes dhe e konsumojnë", thotë Ratko Davidovski, mjek. Dyshimet e Davidovskit janë se ndryshimi i shijes në disa raste para disa muajve, kishte të bëjë me rënien

e gjetheve në ujërat sipërfaqësor, por e njëjta nuk është e dëmshme për shëndetin. Deri në këtë përfundim ka ardhur si pasojë e analizave të bëra edhe në ujëra sipërfaqësorë dhe në disa vende të ujësjellësit. "Nga përvoja jonë mund të them se ndryshimi ka ardhur si pasojë e lëshimit të ujit nga lumenjtë në Leshnicë dhe Lumit Shkumbin në ujësjellësin e ri. Ky ujë, përmes stacionit të filtrimit, kyçet në ujësjellës. Mendimi ynë është se do të duhen të bëhen analiza shtesë të pranisë së algave, apo gjallesave tjera, por në këtë kohë ka edhe rënie të gjetheve, të cilët ne dyshojmë se mund të shkaktojnë ndryshimin e shijes dhe erës së ujit", thotë mjeku Ratko Davidovski.

Megjithatë, mjeku Ratko Davidovski, thotë se duhet që të merren masa shtesë për pastrimin e ujit dhe të bëhen kontrolle të kualitetit të ujit, që të mos vijë sërish deri tek ndryshimi i shijes. Përndryshe, tetovarët furnizohen me dekada të tëra me ujë nga Mali Sharr, i cili edhe pse nuk ka qenë i mjaftueshëm për

nevojat e tetovarëve, megjithatë ka qenë i pastër. Para dy muajve, kur u lëshua në përdorim ujësjellësi i ri, i cili me ujë furnizohet nga Lumi Shkumbin dhe Leshnicë, me ç'rast qyteti ka edhe 200 litra ujë shtesë, megjithatë pas normalizimit të gjendjes me ujin, tashmë tetovarët përballen me një dukuri tjetër, përkatësisht ata kanë dyshime se uji ka një shije jo të mirë. Nga Qendra për shëndet publik, thonë se ata qytetarë që hezitojnë të konsumojnë ujin mund të shfrytëzojnë ujë të ambalazhuar, por uji në Tetovë është i pijshëm.

Përndryshe, para një muaji e gjysmë, uji në Tetovë mbante erë të pazakontë si ajo e pesticideve kimike. Kjo shije u ndje në shumë lagje të Tetovës, prej nga kanë raportuar se uji mban një erë të rëndë, me ç'rast krahas raportimit në rrjetet sociale, po ashtu ata këtë e kanë raportuar edhe në Qendrën për shëndet publik, problemi që tani më një kohë të gjatë është shqetësues në rajonin më të gjerë të Tetovës. Po ashtu, nëpër komunat

rurale shumë pak bëhen analiza të ujit brenda vitit. Nga Qendra për Shëndet publik në Tetovë, thonë se qeveria brenda një viti ndan mjete që gjashtë herë në vit të bëhen analiza, kurse që rezultatet të jenë gjithmonë të saktë duhet që të bëhen 12 analiza brenda vitit. Sipas mjekëve në këtë qendër, ata kryejnë analiza në 92 fshatra në rajonin e ish Komunës së Tetovës.

"Maqedonia ka ujë të pijshëm cilësor, por uji ndotet si rezultat i problemeve me zonat e mbrojtura dhe mungesës së dezinfektimit.

Ne ndotim ujin vetë, me pakujdesinë tonë. Shpesh herë hasim kapakët e rezervuarvë të hapura, hasim në kaptazhe të mbushura me gjethe dhe prania më e vogël e një gjeti në ujë për një kohë të shkurtë krijon bakterie. Me rëndësi është që të mirëmbahen rrjetet e ujësjellësit, ndërsa pjesa më e madhe e ujësjellësve në Tetovë janë mirë të ndërtuar, por kur nuk kujdesemi, mundësia e ndotjes së ujit është e madhe", thekson Davidovski.

EKSPOZITË UDHËTUESE

"Ana Frank - Historia për sot"

Costivar, 15 dhjetor - Në Qendrën për kulturë në Costivar, të enjten në mbrëmje u hap ekspozita udhëtuëse, "Ana Frank - Historia për sot", organizuar nga Forumi Rinor Arsimor. Në hapjen solemne të ekspozitës morën pjesë kryesisht nxënës të shkollave të mesme të Costivarit, të cilët u njoftuan me mesazhet e gazetares dhe shkrimtares Ana Frank, si simbol i qëndresës dhe paqes. Të pranishmit, në emër të kryetarit të Komunës së Costivarit, Arben Taravari, i përshëndeti përfaqësuesja e kabinetit të



tij, Afërdita Hamza.

"Përgëzoj organizatorët për këtë aktivitet, njëkohësisht i falënderoj që përzgjedhën qy-

tetin tonë për mbajtjen e kësaj ekspozite. Komuna e Costivarit, është e hapur për bashkëpunim me sektorin joqeveritar dhe do

t'i mbështesë ata në organizime të këtilla të cilat dërgojnë mesazhe për paqe dhe tolerancë", theksoi znj. Hamza.

Ekspozita "Ana Frank - Historia për sot" është një koleksion prej tridhjetë e nëntë paneleve ekspozuese, të përkthyer në gjuhën maqedonase dhe shqipe, të cilat mbajnë detaje të shumta rreth jetës së vogëlushes Ana dhe familjes së saj, nga Lufta e Dytë Botërore. Ekspozita do të jetë e hapur për vizitorët deri më 30 dhjetor 2017, dhe hyrja është falas.



Promovohet libri "E vërteta për Nolin"

Tetovë, 15 dhjetor - Në ambientet e Fakultetit Filologjik të Universitetit të Tetovës, të premtën u bë përurimi i veprës "E vërteta për Nolin" e autores Entela Komnino. Kjo vepër në shqipëri dhe është vlerësuar si një studim ndryshe për veprën e Nolit. Për librin në fjalë foli profesori i Katedrës së gjuhës dhe letërsisë shqipe në Universitetin e Tetovës, Salajdin Salihu, i cili tha se libri i autores Entela Komnino është kërshërindjellës, për faktin se është një studim për Nolin. "Çdo studim për këtë personalitet kulture e historie është joshës, sepse: Fan Noli është poeti i veçantë, i cili luajti bukur me violinën e gjuhës dhe krijoi një vepër artistike, ku shtresa aktuale sot është hijezuar nga shtresa universale. Ai është përkthyesi sojli, një pasurues i botës sonë kulturore dhe letrare, me reflektim perlash të letërsisë botërore, që njerëzimit i vijnë rralle dhe, si të tilla, janë të dënuara që t'u flasin kohërave me gjuhën e tyre simbolike. Ai është publicisti par excellence, që mund t'ia kontestosh idetë, por jo edhe stilin se si shkruan. Ai është prifti, i cili përktheu në gjuhën shqipe vepra të shumta religjioze, kurse ndjeshmëria prej shkrimtari e mbajti larg dogmës së ngurtë që krijon shtretër Prokrusti. Ai është politikani me fyell, që veprimi në një kohë të çmendur, kur historia kishte përjetuar plasaritje dhe lartësonte dhe rrëzonte nga skena politike, kjo skenë interesash e konfliktesh të mëdha, personazhe tragjikomike, që mbanin në duar edhe fatin e kombit", tha Salihu. Autorja e librit Entela Komnino u shpreh se ky libër sjell një vështrim krejt të ri për figurën e Nolit dhe kulturës shqiptare në tërësi. "E vërteta për Nolin nuk është një provokim me tituj, aq më pak çudibërës, dalë rrethash të mundësive me shumë se 100 vjeçare për përgjigje. Çudia është, por ajo i takon tjetër fakti: brenda mundësive, po ashtu më shumë se 100 vjeçare, pyetja ende e pabërë vazhdon të sfidohet nga e vërteta hartuese: retorika. Brenda mundësive më se mijëra vjeçare të të folurit shqip, nga ana tjetër, tejkalon çdo arsye të grupuara të gjuhëve sipas kombit. E vërteta, me cilën jetoi me çudi edhe përmbi cakat të vdekjes dhe shkroi për shqiptarët Fan Noli, tejçuar sot edhe me kufij të papërfytyrueshëm në kohën e shkrimit të tij si ato të rrjeteve sociale, ka ngritur edhe pa zhvillimet numerike pandehma kuptimi tej atyre pa çudi, pa mbërritur dot gjithsesi në një proces të vijueshëm pyetje e përgjigje, specifikisht të domosdoshëm edhe në kushtet e gjallimit shqip dhe të ndodhive dhe letrave", theksoi Entela Komnino. Entela Komnino jeton dhe vepron në Tiranë. Ka kryer studimet në piano dhe histori arti në Liceun Artistik Tiranë. Në vitin 1994-1995 ka kryer studimet pasuniversitare, retorikë e gazetari televizive në universitetin e Tuebingenit, në Gjermani. Është doktore shkencash në letërsi me disertacionin 'Kodi retorik në publicistikën e Fan Nolit. (u.h.)

Rruga qorre për demarkacion: as për të vazhduar, as për rrugë të re



Nga
Veton SURROI

1.
Për ta larguar mjegullën dyvjeçare që është krijuar me temën e demarkacionit të kufirit me Malin e Zi, iu ktheva një burimi të cilit i besoj, analizës së profesorit Marc Weller, një mendjeje të çiltër juridike dhe një dashamiri të Kosovës, kurdo që ka pasur nevojë për këshillë të tij, prej Konferencës së Rambouillet e tutje. Pra, ky është leximi im, me ndihmën e analizës së tij, për gjendjen nga aspekti i së drejtës ndërkombëtare si vijon. Kosova tashmë ka kufi të njohur ndërkombëtarisht me Malin e Zi. Këtë kufi e kanë shndërruar në pjesë të së drejtës ndërkombëtare në shkruarit në emër të Kosovës dhe Malit të Zi. Mali i Zi këtë nënshkrim e ka ratifikuar në Kuvend dhe ky ratifikim tashmë e bën këtë kufi të mbrojtshëm juridikisht nga e drejta ndërkombëtare dhe, çështje po aq me rëndësi e po qe nevoja, të mbrojtshëm fizikisht edhe nga Artikulli V i Traktatit të NATO-s (natyrisht, nëse invokohet), me të cilin sulmi ndaj njërit anëtar të NATO-s konsiderohet sulm ndaj të gjithëve. Kosova nuk ka në duar instrumente të së drejtës ndërkombëtare me të cilat do ta kontestonte këtë kufi. Në momentin kur Marrëveshja e demarkacionit ka marrë nënshkrimin e përfaqësuesve të pushtetit të Kosovës, Kuvendi i Kosovës mund ta ratifikojë apo jo, por kjo gjë nuk e ndryshon Marrëveshjen. Për më tepër, Kuvendi mund të mos e vërë fare Marrëveshjen në votë për ratifikim; kjo gjë nuk e ndryshon Marrëveshjen apo zbatimin e saj nga ana e Malit të Zi. Jeta vazhdon për tërë botën nëse Kuvendi i Kosovës, gjatë këtij shekulli apo shekujve të ardhshëm, nuk mund të sigurojë votat për ratifikim të Marrëveshjes; vazhdon edhe për ata në Bruksel që e kanë vënë këtë si

kushtin e parafundit për liberalizim të vizave.

2.
Mali i Zi është sjellë me dinjitet dhe kulturë të theksuar të fqinjësisë së mirë. Në asnjë moment nuk e ka politizuar këtë çështje apo shndërruar në kauzë për të ndryshuar natyrën e marrëdhënieve me Kosovën. Dhe, pos pjekurisë shtetërore, ekziston edhe një arsye e thjeshtë për këtë sjellje: për të, siç deklarojnë zyrtarët e saj, çështja e demarkacionit ka përfunduar, rrjedhimisht kjo është çështje e brendshme e Kosovës. Një deklarim i këtillë ka peshë të veçantë, sepse heq nga dora e Kosovës edhe dy instrumente të cilat supozohej se i kishte. Njëri është marrëveshja apo rrimarrëveshja për kufi dhe tjetri është dërgimi i çështjes në arbitrazh. Për që të dyja nevojitet pëlqimi i Malit të Zi, pëlqim të cilin ky vend ka deklaruar se nuk e jep. Edhe po të kishte vullnet minimal në Qeveri për të dhënë një pëlqim të këtillë, juridikisht kjo do të nënkuptonte që Mali i Zi të prishte ratifikimin e bërë në Parlament dhe t'i haptë rrugë një procesi të ri negociator (apo arbitrazhi). Ky do të ishte një hap i rrezikshëm për integritetin e Malit të Zi, sepse nëse Kuvendi mund të prishë ratifikimin e një marrëveshjeje ndërkombëtare siç është ajo e kufirit me Kosovën, atëherë kështu bëhet precedenti për prishjen e ratifikimit të marrëveshjeve të tjera. Atëbotë nuk do të ishte larg ideja e orkestrimit të një presioni të ri prorus në Mal të Zi për të prishur, për shembull, ratifikimin e Marrëveshjes së Malit të Zi për anëtarësim në NATO. Mali i Zi nuk ka pse të luajë bixhoz me veten, siç është mësuar ta bëjë Kosova. Atëherë, kur të hiqen të gjitha këto instrumente të së drejtës, i vetmi instrument i mbetur është politik.

Jeta vazhdon për tërë botën nëse Kuvendi i Kosovës, gjatë këtij shekulli apo shekujve të ardhshëm, nuk mund të sigurojë votat për ratifikim të Marrëveshjes; vazhdon edhe për ata në Bruksel që e kanë vënë këtë si kushtin e parafundit për liberalizim të vizave



Pra, Kosova ka në duar mundësinë që t'i bindë SHBA-në dhe BE-në se duhet një marrëveshje e re (apo arbitrazh). Gjasat për një gjë të tillë nuk duken fare, ngase SHBA-ja qëndron tashmë zyrtarisht prapa Marrëveshjes së tanishme dhe një gjë të tillë e kanë deklaruar edhe zyrtarët e BE-së. Ah, po, nëse do sqarim plotësues për raportet politike dhe kapacitetit të Kosovës për ta bindur ndokënd: Mali i Zi është anëtar i NATO-s dhe shtet kandidat për t'u anëtarësuar në BE (ndoshta më 2025) e Kosova është shtet i kontestuar prej pesë anëtarëve të BE-së dhe katër shteteve anëtare të NATO-s (me gjasa për anëtarësim krejtësisht të padefinuara)

3.

Në situatën e tanishme Qeveria e Kosovës ka proceduar në Kuvend Ligjin për Ratifikimin e Demarkacionit dhe Raportin e Komisionit të formuar për të gjetur gabimet e Komisionit të kaluar. Meqë Raporti i Komisionit nuk ka karakter ligjor, është thjesht informativ, Kuvendi i Kosovës duhet të deklarohet për Projektligjin. Pra, Kuvendi nuk do të ketë propozim të ri. Deklarimi i tij kërkohet për Marrëveshjen e Vjenës, ashtu si më 2015. Prej vitit 2015 dy gjëra nuk

kanë ndryshuar. Lista Serbe nuk do të votojë për ratifikim të Marrëveshjes, meqë me këtë do ta njihte Kosovën si shtet të pavarur, i cili po i rregullon kufijtë me shtetet fqinje. AAK-ja, partia e kryeministrit të vendit, ka paralajmëruar se nuk do të votojë për shkak të bindjeve se Marrëveshja e Vjenës është në dëm të Kosovës. Me këtë raport forcash, nëse del për votim në Kuvend, Ligji për Ratifikim të Demarkacionit nuk do të marrë dy të tretat e votave të nevojshme për të kaluar. Rrëzimi i ligjit në legjislacionin kosovar mund të nënkuptojë hapjen e rrugës për një ligj tjetër, por jo edhe në të drejtën ndërkombëtare. Rrëzimi i Ligjit për demarkacion të kufirit me Malin e Zi, për Malin e Zi nuk ka kurrfarë pasojash juridike. Nuk ka as për SHBA-në, BE-në dhe NATO-n. Rrjedhimisht, nuk hapet rruga për një marrëveshje të re. Për më tepër, çfarëdo propozimi unilateral i Kosovës për kufi të ri mund të interpretohet negativisht, prej shpërfilljes së marrëveshjeve ndërkombëtare e deri tek intencat për rrezikim të fqinjësisë së mirë. Atëherë, tri gjëra nuk po ndodhin. Kosova nuk ka propozim të ri për kufi me Malin e Zi. Kosova nuk ka forcë politike për ta ratifikuar Marrëveshjen e tillë siç është. Kosova nuk ka forcë politike (e as argumente të reja) me të cilat do t'i bindë Malin e Zi, SHBA-në dhe BE-në se duhet një marrëveshje e re apo arbitrazh.

4.

Kjo udhë qorre është aq qorre saqë edhe në një situatë hipotetike që Komisioni qeveritar të gjente me të vërtetë 8 mijë hektarët e humbur, dhe që të gjithë në Kosovë të ishin të bindur për këtë, nuk ka veshë ndërkombëtarë, juridikë e politikë për të dëgjuar. Nuk është hera e parë që ndodh kështu. Prej shpal-

ljes së Pavarësisë së Kosovës e këtej - pra, u bënë dhjetë vjet - vendi ka kaluar prej një sfide diplomatike në tjetrën, prej gjashtë pikave të Ban Ki-moonit, Marrëveshjes së Brukselit, themelimit të Gjykatës Speciale e deri te Marrëveshja për demarkacion. Në të gjitha ndodh e njëjta rrjedhë: krijohet një propozim jashtë vendit, u jepet një a dy njerëzve përgjegjës në vend, ata një a dy njerëz marrin vendim duke thënë se është në të mirë të Kosovës (dhe se nuk kanë pasur çare), pastaj kërkohet përkrahje dhe në fund fajësojnë të tjerët për pasojat. Dikush nga jashtë gjithnjë ka faj: Ban Ki-mooni pse i harton gjashtë pikat, Serbia për çdo gjë, BE-ja për dialogun e Brukselit, gjithkush tjetër për kufirin me Malin e Zi, Lista Serbe për Ushtrinë e ratifikimin dhe çdo gjë tjetër që nuk shkon. Por, për dhjetë vjet rresht, partitë politike të shumicës, partitë politike të shqiptarëve në asnjë moment të vetëm nuk kanë krijuar marrëveshje konsensusi, prej gjashtë pikave e deri te demarkacioni. Gjithnjë ka ekzistuar një subjekt apo një njeri, i cili ka interpretuar vullnetin e shumicës. Dhe, kështu kemi arritur, me demarkacion, te simbolizimi i rrugës qorre: as jemi për të vazhduar e as jemi për ndonjë rrugë të re. Para se të përpqeshin t'i bindnin Malin e Zi, SHBA-në, BE-në dhe NATO-n, partitë shqiptare bënin mirë ta bindnin njëra-tjetrën. Ndoshta do të gjenin rrugë për të dalë nga kjo gjendje. Me fjalët e tyre, ndoshta do të ishin në gjendje të "merrnin vendime të mëdha". Apo, ndoshta, prapë me fjalët e tyre, duan të presin që ndonjërit prej tyre "t'u hapet rruga për vendime të mëdha". Sidoqoftë, nëse nuk ulen të bisedojnë, nuk do të mund të gjejnë dalje nga rruga qorre. E, ajo ekziston. (koha.net)

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi


Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Gocë Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e premtë 15 dhjetor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Ndhimskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktorë: Shkëlzen HALIMI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

FJALËKRYQI KLASIK

HORIZONTALISHT

- 3. Rrëzohet
- 5. Ka i ri, i patredhur
- 7. Vepra e shkruar në vargje
- 9. Nxjerr një përfundim që lidhet me diçka
- 10. Veshje nga pambuku me vija e me lule ngjyrash të ndryshme
- 12. Organet e të dëgjuarit
- 13. Zanore e bashkëtingëllore
- 14. Ato që zotërojnë një pronë
- 18. Inicialet e këngëtares Babaliu
- 20. Mjeshtëri artistike
- 21. Maqedonia
- 22. Opus
- 24. Vend i cekët në një lumë
- 25. Kërcimtar në balet
- 27. Magjistër
- 28. Ish boksieri amerikan, Holms
- 29. Ish zonja e parë amerikane (gruaja e Bushit)
- 32. Qytet në Ukrainë
- 33. Qytet në Itali
- 35. Fshat në komunën e Petrovecit (banja)
- 37. E panjohura e parë në matematikë
- 39. Qytet në Japoni
- 40. I përhimët
- 41. Me të meta mendore
- 42. Shegë
- 45. Alternativë (shkurt.)
- 46. Aktori kosovar Thaqi (Cima)
- 49. Qeleshe.




VERTIKALISHT


- 1. Prodhim drithi
- 2. Jo thellë
- 3. Lloj gjarpri
- 4. Jo e vogël
- 5. Shtrat gjumi
- 6. Vit
- 8. Inicialet e politikanit Xhaferi
- 9. Gjuhë gjermane
- 11. Inicialet e autorit Pashku
- 12. Inicialet e poetes Antoni
- 15. Radiumi
- 16. Shkrimtarja dhe fotografja tiranase në foto
- 17. Nitoni
- 19. Këngëtar rege xhamaikan
- 23. Flokë artificiale
- 24. Mikroorganizma që shkaktojnë sëmundje ngjitëse
- 26. Ujdhesë në Kroaci
- 29. Ai që pret drurë me latë
- 30. Arena e boksit
- 31. Bebëza e syrit
- 32. Lëndë e parë për prodhimin e çokolletës
- 34. Hero i Luftës së Trojës
- 35. Një trup gjeometrik
- 36. Numri gjashtë romak
- 38. Këtë ditë
- 43. Sherifi i njohur i Perëndimit të egër, Vajat
- 44. Përemër pronor
- 47. Politikani Ahmeti
- 48. Heroi Boletini.

Kakuro


e lehtë



mesatare



e vështirë



KOHA e lirë për më të rinjtë


DETEKSIONI

Figurat e dhëna fshihen diku në fotografi. Ku?



ZBULIMI

Ngjyrosni fushat me pika që të zbuloni figurën!




VIZATIMI

Vizatoni duke i bashkuar pikat me radhë!



LABIRINTI

Ndihmoni dinosaurëve të arrijnë deri te grupi.



DALLIMET

Cilët janë 5 dallimet në fotografitë e mëposhtme!



DOMINOJA

Bashkoni numrat nga dy, ashtu që të fitohen figurat e lojës së dominos.

2	2	0	6	0	5	3	2
1	3	3	5	5	1	0	5
2	5	0	1	1	4	4	4
6	5	3	3	3	2	6	6
3	2	0	0	6	5	2	6
1	0	4	6	1	0	1	4
6	2	4	4	4	1	5	3


DREJTKËNDËSHIT

Numrat e dhëna tregojnë hapësirën e drejtkëndëshit. P.sh. numri 2 tregon se duhet të bëni drejtkëndësh prej dy kutive.

		2			7
3					
		8			
2					
2	12		2	12	6
			7		
	2				
2		10			4

MARGARITARI

Lidhni pikat ashtu që të mos mbetet asnjë fushë e pakaluar. Pikat e zeza paraqesin skajet (kthesat) e vijës.



MOSBARAZIMI

Plotësoni tabelën duke u bazuar në operacionin e mosbarazimit. Përdoren numrat prej 1 deri 4.

	<	<		
			>	
		3		
3				

TRANSFORMIMI

Transformoni FOLJEN në DRINË, duke zëvendësuar nga një shkronjë.

1	F	O	L	J	E
2					
3					
4					
5					
6	D	R	I	N	A

Bileta e "trenit" që tërhiqej me kalë ose mushkë ishte 2 franga ari për çdo person ndërsa për 1 kuintal plaçka paguhej një tarifë prej 1 frangë ari

Gjatë Luftës së Parë Botërore, ushtritë austro-hungareze e ato italiane që qëndruan në Shqipëri ndërtuan linja hekurudhore (dekovilë). Në përfundim të luftës, një pjesë e materialeve të këtyre ushtrive do të mbetej në Shqipëri. E në listën e sendeve të mbetura do të ishin edhe disa vagonë e shinat e dekovilëve. Një nga linjat që kishte mbetur ishte ajo Durrës-Kavajë-Rrogozhinë-Lushnje-Berat.

Në vitin 1920, kjo linjë u rivedos në funksionim, por në mungesë të një lokomotive do të përdorej mushka ose kali për tërheqjen e vagonëve. Fillimisht do të ishin misionarët amerikanë të Kryqit të Kuq që do të jepnin këtë ide për që i jepte zgjidhje (sadopak) çështjes së transportit në Shqipërinë e atyre viteve. Këta të fundit do ta emërtonin "Express-i Tiranë-Durrës" këtë mjet transporti të sajuar. E në fakt, nga kjo veprimtari do të përfitonte edhe arka e shtetit. Bileta e "trenit" që

SHQIPËRIA EVITIT 1920

HISTORIA E TRENIT TË ÇUDITSHËM "TIRANË-DURRËS EXPRESS"



tërhiqej me kalë ose mushkë ishte 2 franga ari për çdo person ndërsa për 1 kuintal plaçka paguhej një tarifë prej 1 frangë ari.

Në vitin 1923 do të bëhej përpjekje për ta dhënë me koncesion këtë linjë transporti e fitues i koncesionit do të ishte një ish deputet, Mustafa Maksudi nga Gjirokastra. Me 5 prill të vitit 1923 do të merrte fuqi ligjore kontrata, sipas së cilës koncesionari do të manaxhonte këtë linjë transporti për 15 vite, me kushtin që brenda 5 viteve të sil-

lej një lokomotivë për tërheqjen e vagonëve e të hiqej përdorimi i kafshëve. Materialet për mirëmbajtjen e linjës përjashtoheshin nga taksat doganore. Koncesionari kishte detyrimin që t'i paguante shtetit një përqindje nga fitimet. Tarifa e transportit parashikohej të rinegociohej pas 6 muajve me marrëveshje me koncesionarin.

Koncesionari do të niste punën sipas këtyre dispozitave megjithatë do të rezultonte se nuk do t'i përmbahej kushteve të kontratës. Haxhi

Shkoza të "Financat e Shqipnis" shkruan se "i janë kërkuar llogaritë për veprimet përkatëse dhe jo vetëm këto, por as nuk është gjetur as vetë sipërmarrësi".

Në këto kushte, qeveria do të anulonte kontratën koncesionare e do të rihapte tenderin për dhënie me koncesion në shtator të vitit 1924 dhe në mars të vitit 1925 pa aritur të ketë asnjë ofertues. Në këtë mënyrë, administrimi i kësaj linje do t'i mbetej sërish administratës shtetërore të vendit që për transpor-

tin do të përdorte tarifën e mëparshme.

Administrimi shtetëror i kësaj mënyrë transporti do të vijonte edhe për pak kohë kur me vendosjen e stabilitetit, nisjen e ndërtimit të rrugëve e futjes automjeteve apo avionëve të vegjël, situata e transportit do të shënonte një përmirësim duke e zhdukur nevojën e përdorimit të këtij dekovili të çuditshëm që mishëronte dy anë të kundërta të zhvillimit të një vendi. (SCAN)

Publicitet

T...

15 GB 4G INTERNET
OFERTË MAGJIKE
PËR TËRË FAMILJEN

ME
MAGENTA 1 M
TË RE

NDAJI PËRJETIMET

ASNJË ARSYE NUK KA QË NDALON LËVIZJEN E LIRË PËR KOSOVËN



“Ashtu sikundër nuk dua të harroj në asnjë mënyrë, prandaj e ndava nga vendet e tjera, Kosovën. Kosova meriton të shoqërohet dhe të përparojë dora-dorazi me fqinjët dhe nuk meriton të mbetet akoma e izoluar. Është i katërti vit që unë e mbaj këtë fjalë dhe janë katër vjet ku duhet ta përsëris, i vetmi popull në gjithë kontinentin që nuk lëviz dot lirisht”, ka thënë Rama

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka përsëritur për të katërtin vit radhazi në pritjen e fundvitit me ambasadorë e përfaqësues diplomatikë të akredituar në Shqipëri duke u kujtuar atyre se Kosova është i vetmi popull në gjithë kontinentin që nuk lëviz dot lirisht dhe këtë fat nuk e meriton. “Ashtu sikundër nuk dua të harroj në asnjë mënyrë, prandaj e ndava

nga vendet e tjera, Kosovën. Kosova meriton të shoqërohet dhe të përparojë dora-dorazi me fqinjët dhe nuk meriton të mbetet akoma e izoluar. Është i katërti vit që unë e mbaj këtë fjalë dhe janë katër vjet ku duhet ta përsëris, i vetmi popull në gjithë kontinentin që nuk lëviz dot lirisht. Unë i di edhe arsyet e thëna, vija e kufirit me Malin e Zi arsyeja e fundit e thënë, nuk jam i sigurt nëse

po u zgjidh kjo nuk do të dalë një arsye tjetër, por jam i sigurt për një gjë, që asnjë arsye nuk është mbi arsyen e qytetarëve të Kosovës për të qenë të barabartë në lëvizjen e tyre të lirë, sepse ndryshe nga ne shqiptarët e Shqipërisë, ata kanë dhe një problem tjetër të vështirë për të zgjidhur në mendjen e tyre, ish-in nën diktaturë dhe lëviznin lirisht në Evropë, janë të pavarur dhe

nuk lëvizin dot lirisht në Evropë”, ka deklaruar kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në takimin e fundvitit me trupin diplomatik të akredituar në Shqipëri. Shefi i Qeverisë Shqiptare, Edi Rama, në takim me diplomatë të akredituar në Tiranë, por edhe me ata evropianë që kanë vizituar Shqipërinë, nuk ka hezitur ta konsiderojë mungesën e vizave për Kosovën si turpin e BE-së.



Refugjatët nën qiell të hapur

Të paktën 500 refugjatë dhe imigrantë janë duke jetuar në Serbi në kushte të improvizuara apo nën qiell të hapur, ndonëse moti po fillon të ashpërsoset çdo ditë, ka thënë anëtarë të organizatës, Mjekët pa Kufij. Më shumë se 100 imigrantë jetojnë në zonën e Soborit në veri të Serbisë, është thënë nga organizata me bazë në Francë. Imigrantët kanë thënë se dëshirojnë të kërkojnë ndihmë në kampet e ofruara nga shteti mirëpo

frikësohen se mund të largohen nga vendi, pasi ata planifikojnë që të vazhdojnë rrugëtimin e tyre për të arritur në vendet e Evropës Perëndimore. Komisariati serb për refugjatë, i cili është përgjegjës për kujdesin ndaj refugjatëve dhe imigrantëve, konsideron se ka mjaftueshëm hapësira për ata që paraqiten në qendrat për imigrim në Serbi. Sipas të dhënave zyrtare në këto qendra aktualisht banojnë 4150 persona.

Shqiptarët kryesojnë listën e emigrantëve të kthyer

Organizata Ndërkombëtare e Migrimit (IOM) ka bërë me dije se Shqipëria është vendi që ka përfutur më tepër nga programi i saj i kthimit dhe riintegritimit në atdhe, për vitin 2016. Sipas të dhënave, 17'976 shqiptarë janë kthyer në vend, duke kryesuar listën që ndiqet nga irakienët, afganët, serbët, shqiptarët e Kosovës etj. Organizata Ndërkombëtare e Migrimit (IOM) ka zbatuar një projekt që ka të bëjë me kthimin dhe riintegritimin e emigrantëve që nga viti 1979, cilësohet në një raport të fundit të publikuar. Pikat kryesore të mbështetjes nga IOM-i për emigrantët e kthyer përfshijnë një gamë të gjerë si: ofrimin e këshillimit të para-nisjes, blerjen e biletave të fluturimit, ndihma e udhëtimit dhe ku të jetë e mundur, ofrimi i ndihmës për riintegritim. Mesatarisht, ndërmjet viteve 2005 dhe 2014, IOM ka ndihmuar 34,000 migrantë në vit. Në linjë me rritjen e vëllimit të migrimit në vitet e fundit, numri i kthimeve është rritur dukshëm.

Haradinaj: Shumë turizëm, dje tre ministra në Paris

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj sërish ka dhënë vërejtje për ministrat e tij të cilët mungojnë në seanca plenare. Haradinaj para mbledhjes së Qeverisë së Kosovës tha se nëse një ministër nuk është në seancë është mirë të njoftohet sekretariati i Kuvendit dhe kryeministri. “Nëse një ministër nuk është në seancë është mirë më shkrujt një shkresë sekretarit të Parlamentit dhe është mirë me njoftu dhe kryeministrin. Dje i kemi pasur tre ministra në Paris, pak si tepër ky turizmi duhet me ia vnu mendjen pak me u marrë vesh, ku po shkojmë, pse po shkojmë. S'ka logjik si rasti i djeshëm në parlament. Në parlament nuk ka nevojë me nejt qeveria gjithë ditën por me bamos me qëllu aty kur është tema jote është jo serioze. Unë i kam ngarku 4 apo 5 vetë, një këshilltar i juaj duhet të jetë në seancë, një staf apo dikush. Dërgone dikë që e përcjell seancën, të rrinë dikush i yti aty, nëse i ke pesë këshilltarë e qon një rrinë aty”, tha Haradinaj.



Ushtria e Asociacioni, në agjendën e 2018-s

Qeveria e Kosovës ia ka përshkruar vetes katër prioritetet strategjike për 2018-n. E, midis veprimeve që ka paraparë t'i ndërmarrë gjatë këtij viti është themelimi i Forcave të Armatosura dhe i Asociacionit të komunave me shumicë serbe, por në to nuk figuron edhe ratifikimi i Marrëveshjes së kufirit me Malin e Zi, shkruan sot Koha Ditore. Të dhënat ndodhen në draftin e programit vjetor të Qeverisë për vitin e ardhshëm, i

cili akoma nuk është miratuar. Është hartuar edhe drafti i programit legjislativ, si dhe plani vjetor i dokumenteve strategjike. Në këto dokumente janë paraparë të hartohen 45 projektligje dhe që pastaj t'i procedohen Kuvendit, si dhe 35 strategji. Midis projektligjeve të listuara është edhe ai për Forcat e Armatosura të Kosovës. Në program nuk janë paraparë amendamente kushtetuese, nëpërmjet të cilave komuniteti

ndërkombëtar ka kërkuar që të themelohet ushtria. Megjithatë, në draftin e planit të punës së Qeverisë për vitin 2018 është theksuar se transformimi i Forcës së Sigurisë në Forca të Armatosura do të bëhet “në bashkëpunim të ngushtë me partnerët strategjikë të Kosovës, duke siguruar kështu vazhdimin e përkrahjes së plotë në profesionalizimin e forcave tona të armatosura sipas standardeve të NATO-s”.



KUR ARRESTOHEN DHE ABUZOHEN FËMIJËT!

"Tre ushtarë më zhveshën lakuriq dhe më kontrolluan për më shumë se 30 minuta. Më mbajtën në një dhomë për më shumë se tre orë pa ujë dhe pa ushqim", thotë 15 vjeçari palestinez

Amjadi, një djalë palestinez 15 vjeçar, nuk mund ta harrojë momentin kur u arrestua dy muaj më parë nga ushtarët izraelitë në Bregun e pushtuar Perëndimor, raporton Anadolu Agency (AA). "E kujtoj incidentin sikur të ishte dje", thotë Amjadi për AA, familja e të cilit preferonte të mos jepte mbiemrin e tij. Djali palestinez u arrestua gjatë pjesëmarrjes në një tubim në fshatin Nabi Saleh të Bregut Perëndimor. "Më mbajtën për më shumë se dy orë në një automjet ushtarak dhe me sy të mbyllur, gjatë së cilës ushtarët më fyenin", kujton ai. Me një shikim të tmeruar në fytyrën e tij, Amjadi tha se ishte dërguar në një bazë ushtarake pranë fshatit ku thotë se ai ishte nënshtruar abuzimit fizik. "Tre ushtarë më zhveshën lakuriq dhe më kontrolluan për më shumë se 30 minuta. Më mbajtën në një dhomë për më shumë se tre orë pa ujë dhe pa ushqim", thotë Amjadi. Përderisa babai i tij e përqafoi, Amjadi vazhdoi të tregonte rrëfimin e tij, duke kujtuar se si ishte dërguar në një dhomë tjetër për marrje në pyetje. "Oficeri izraelit më bërtiste gjatë gjithë kohës. Pasi refuzova t'i përgjigjem njëres prej pyetjeve të tij, ai më goditi tre herë në stomak", tha ai. "Nuk munda të marr frymë dhe kisha të vjellura nga dhimbja", tha fëmija i zemëruar, i cili nuk ishte në gjendje për të vazhduar të tregojë atë çfarë kishte përjetuar. Në atë moment, babai i Amjadit i mllëfosur tha se djali i tij ishte liruar nga burgimi 48 orë më vonë.



ABUZIMI

Grupet e të drejtave të njeriut thonë se Izraeli në mënyrë të zakonshme arreston fëmijët palestinezë. "Forcat izraelite arrestojnë fëmijë pavarësisht nga mosha apo gjinia e tyre", tha Qadura Fares për AA, kreu i Shoqërisë së të Burgosurve Palestinezë, duke theksuar se sipas ligjit ndërkombëtar, të gjithë nën moshën 18 vjeç konsiderohen fëmijë. Fares theksoi se disa raste të arrestimeve të fëmijëve nën moshën 7 vjeç nga forcat izraelite ishin dokumentuar gjatë dy dekadave të fundit. "Kjo tregon një shkelje të konventave ndërkombëtare dhe një mospërfillje të qartë ndaj Kartës së OKB-së për të drejtat e njeriut. Bota duhet të marrë një qëndrim të vendosur kundër krimeve izraelite ndaj fëmijëve tanë, të cilët po abuzohen çdo ditë nga pushtimi izraelit", tha ai. Arrestimi i fëmijëve palestinezë dominoi këtë javë pasi ushtarët izraelit arrestuan një djalë adoleshent në Bregun Perëndimor gjatë një proteste kundër vendimit të SHBA-ve për të njohur Kuds si kryeqytet të Izraelit dhe për të zhvendosur ambasadën amerikane nga Tel Avivi në qytetin e shenjtë. 16 vjeçari Faws al-Xhuneidi u arrestua javën e kaluar gjatë përleshjeve në Bregun Perëndimor në qytetin Hebron dhe u tërhoq zvarrë me sy të mbyllur nga ushtarët izraelitë. Fotografia e fëmijës me sy të lidhur është bërë simbol i protestave të vazhdueshme palestineze kundër politikës së SHBA-ve për Kuds. Sipas Shoqatës Palestineze të të Burgosurve, rreth 100 fëmijë palestinezë janë arrestuar nga forcat izraelite që kur presidenti i SHBA-ve, Donald Trump, njoftoi vendimin javën e kaluar.

"SISTEMATIK"

Grupet e të drejtave të palestinezëve thonë se pjesa më e madhe e fëmijëve të arrestuar i nënshtrohen abuzimit psikologjik ose fizik gjatë kohës së arrestimit. "Rreth 90 për qind e fëmijëve të arrestuar i nënshtrohen abuzimit verbal dhe

poshtërimit nga oficerët e ushtrisë izraelite", tha Ayed Abu Qtaish për Aa, nga Grupi për Mbrojtjen e të Drejtave të Palestinezëve. Ai shtoi se 82 për qind e fëmijëve të arrestuar janë zhveshur lakuriq për kontroll, ndërsa 30 për qind i janë nënshtruar abuzimit fizik përdërisa ishin në paraburgim. Sipas Abu Qtaish-it, mbi 75 për qind të fëmijëve të arrestuar u është mohuar qasja në këshilla ligjore para se të merren në pyetje. "Këto nuk janë incidente të izoluar, por praktikë standarde nga ushtria izraelite. Okupimi izraelit ushtron këtë politikë sistematike me qëllim frikësimin e fëmijëve palestinezë", tha ai. Kreu i Komitetit të Kudsit për Familjet e të Burgosurve, Amjad Abu Assab, tha se forcat izraelite kanë arrestuar 19 fëmijë në bastisjet gjatë natës që nga java e kaluar. "Secili nga këta fëmijë të arrestuar pësoi plagë plumbash, të prekur nga gazi lotsjellës ose janë rrahur nga forcat izraelite gjatë paraburgimit", tha Assab. Sipas Shoqatës Palestineze të të Burgosurve, rreth 300 fëmijë vazhdojnë të mbahen në objektet e paraburgimit në Izrael.

QËNDRIMI I BE-së PËR KUDSIN ËSHTË I QARTË

Shefja e politikës së jashtme të Bashkimit Evropian (BE), Federica Mogherini, përsëriti pikëpamjen e unionit se Kuds është "kryeqyteti i dy shteteve" bazuar në kufijtë e vitit 1967. "Bota e di qëndrimin e BE-së lidhur me Kuds", tha Mogherini duke folur për gazetarët në prag të samitit të krerëve të BE-së në Bruksel. "Kryeqyteti i dy shteteve: shtetit të Izraelit dhe shtetit të Palestinës, sipas kufijve të vitit 1967. Ne po punojmë për ta dhënë këtë



perspektivë, gjë që do të qëndrojë si pozicioni i BE-së pavarësisht çfarë ndodh", shtoi ajo. Ndryshe, presidenti amerikan Donald Trump më 6 dhjetor shpalli njohjen e Kudsit si "kryeqytet i Izraelit" dhe paralajmëroi zhvendosjen e ambasadës në këtë qytet. Vendimi i SHBA-ve ka shkaktuar reagime të shumta në nivel rajonal dhe ndërkombëtar, ndërsa në shumë shtete vazhdojnë të organizohen protesta.

PAKISTAN LARGON ORGANIZATAT BAMIRËSE, MIJËRA PERSONA DO TË MBESIN PA NDIHMA

Grupet ndërkombëtare për ndihmë të cilat janë urdhëruar të largohen nga Pakistani kanë thënë se mijëra viktimave të dhunës dhe fatkeqësive natyrore mund t'iu ndalohej kujdesi për shpëtimin e jetës, si rezultat i këtij vendimi. Autoritetet pakistaneze kanë urdhëruar për largimin e 20 organizatave të bamirësisë brenda dy muajsh, duke përfshirë Fondacionin për Shoqëri të Hapur të Goerge Soros dhe organizatën e bamirësisë për ndihmën ndaj grave, kanë thënë këto organizata



dhe zyrtarë të ministrisë së Brendshme. Fondacioni për Shoqëri të

Hapur ka thënë se këtyre organizatave u janë dhënë 90 ditë për të

bërë kërkesë ndaj këtij vendimi, mirëpo nuk "është e qartë se si mund të zhvillohet ky proces". Forumi Humanitar në Pakistan, i cili përfaqëson grupet ndërkombëtare për ndihmë, ka thënë se nga puna e këtyre organizatave përfitojnë rreth 29 milionë persona në Pakistan. Ky hap i qeverisë ishte menduar vite më parë, pasi sipas tyre disa prej këtyre grupeve janë përdorur si fronte të spiunazhit nga vendet Perëndimore. Muajin e kaluar është dëbuar edhe organizata Mjekët pa Kufij, e cila është

detyruar të largohet ndonëse aktiviteti i saj ishte shtrirë afër kufirit afgan, ku qeveria është përlëshur me grupe ekstremiste gjatë viteve të fundit. Pakistani ka miratuar kufizime të ashpra për organizatat e bamirësisë që prej deklaratave të dyshimta se grupi Save the Children ka nisur një fushatë të rrejshme të vaksinimit, përmes së cilës CIA ka pasur qëllim të gjejë se ku ishte duke jetuar më 2011, lideri i atëhershëm i Al-Qaeda, Osama bin Laden. Save the Children i ka hedhur poshtë këto akuza.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nënpusëve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16 dhe 142/16“) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 90/15“), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 27/14, 199/14 dhe 27/16“) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rejshe me gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 34/15“), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 39/2017

për punësimin e 3 nëpunësve shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Kuvendin e Republikës së Maqedonisë“ për vendet e punës në vijim:

1. UPR0101V03000 Ndhmës udhëheqës i 1 realizues(ë)

Sektorit të sekretarit gjeneral të Kuvendit,
Sektorit të sekretarit gjeneral të Kuvendit

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat juridike, shkencat politike ose shkencat ekonomike.
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arrijtje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohje të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) nëpërmjet posedimit të certifikatës të pranuar ndërkombëtarisht e të lëshuar nga testatorët oficalë evropianë, anëtarë të asociacionit ALTE të testatorëve të B2 niveli i CEFR, përkatësisht IELTS me 3,5 – 4,5 pikë, PET, BEK P, BULATS, ose TOEFL PBT së paku 450 pikë, TOEFL CBT së paku 135 pikë ose TOEFL IBT së paku 45 pikë, ose DELF, TCF, TEF, ose certifikatë Gete.

njohja e gjuhës angleze mund të dëshmohet edhe me dorëzim të certifikatës së pranuar ndërkombëtarisht nga STANAG 6001 standarde të NATO-s në nivelin përkatës, ku nëpunësit administrativë nga kategoria B3 dhe B4 duhet të posedojnë certifikatë me STANAG 2222

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30

Rroga neto: 31.313,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2017 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

2. UPR0101B04000 Udhëheqës i njësisë 1 realizues(ë)

për mbështetjen e punës së sekretarit gjeneral të Kuvendit, Sektorit të sekretarit gjeneral të Kuvendit.

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat juridike, shkencat politike ose shkencat ekonomike.
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arrijtje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohje të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) nëpërmjet posedimit të certifikatës të pranuar ndërkombëtarisht e të lëshuar nga testatorët oficalë evropianë, anëtarë të asociacionit ALTE të testatorëve të B1 niveli i CEFR, përkatësisht IELTS me 3,5 – 4,5 pikë, PET, BEK

P, BULATS, ose TOEFL PBT së paku 450 pikë, TOEFL CBT së paku 135 pikë ose TOEFL IBT së paku 45 pikë, ose DELF, TCF, TEF, ose certifikatë Gete.

njohja e gjuhës angleze mund të dëshmohet edhe me dorëzim të certifikatës së pranuar ndërkombëtarisht nga STANAG 6001 standarde të NATO-s në nivelin përkatës, ku nëpunësit administrativë nga kategoria B3 dhe B4 duhet të posedojnë certifikatë me STANAG 2222

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30

Rroga neto: 28.286,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2017 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

3. UPR0101V04000 Bashkëpunëtor i ri për 1 realizues(ë)

realizimin e kontakteve me deputetët për njësitë zgjedhore 4,5,6, Njësia për kontaktet e deputetëve me qytetarët e njësive zgjedhore, Sektorit të sekretarit gjeneral të Kuvendit.

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat juridike, shkencat politike dhe shkenca për letërsi.
- me ose pa përvojë pune

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arrijtje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune – teksti i pastruar (Gazeta Zyrtare nr. 167/2015), nenit 5 dhe 8 të Marrëveshjes kolektive të “M-NAV” SHA Shkup, Rregullore për sistematizim të vendeve të punës në “M-NAV” SHA Shkup, dhe Pëlqimit të marrë nga Ministria e financave të RM nr. 18-11173/4 të datës 01.12.2017, “M-NAV” SHA Shkup publikon

SHPALLJE PUBLIKE
Për themelimin të marrëdhënies së punës

Për nevojën për punësim të punëtorëve për kohë të pacaktuar të punës për vendet e punës në vijim:

1. Këshilltar (Departamenti për planifikim, zhvillim dhe këmbim ndërkombëtar) - 1 (një) realizues
2. Këshilltar (Departamenti për resurse njerëzore) - 1 (një) realizues
3. Këshilltar (Departamenti për çështje juridike) - 1 (një) realizues
4. Këshilltar (Departamenti për punë të përgjithshme) 1 (një) realizues
5. Këshilltar (Departamenti për marrëdhënie me publikun) 1 (një) realizues
6. Këshilltar (Departamenti për financa) 1 (një) realizues

Kandidatët krahas fletëparaqitjes për punësim dhe biografiës së shkurtër (CV) është e nevojshme që të përmbushin edhe kushtet e përgjithshme të parashtritura edhe dokumentet në vijim:

- certifikatë të lindjes;
- certifikatë të shtetësisë;
- certifikatë se nuk është i dënuar, të mos i jetë shqiptuar dënime ose sanksion për kundërvajtje, ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Krahas kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme:

- Kandidati për vendin e punës me numër rendor 1, ka të bëjë për – Këshilltar (me fakultet ekonomik) në Departamenti për planifikim, zhvillim dhe këmbim ndërkombëtar; dhe duhet të ketë të mbaruar PSP – shkalla VII/1 (shtatë) – diplomë universitare nga sfera e ekonomisë, me së paku 240 kredi sipas SETK. Është e nevojshme që së paku të ketë 6 (gjashtë) vjet përvojë pune. Kandidati duhet të parashtrorë diplomë ose certifikatë për fakultet të mbaruar (original ose kopje të vërtetuar në noter) dhe vërtetim për përvojën e punës (listë nga SIPM). Gjithashtu duhet të ketë edhe kualifikime, aftësi dhe shkathtësi të tjera profesionale, kualitete personale ndërsa posaçërisht: dëshmi për njohje të gjuhës angleze me dorëzimin e certifikatës minimum niveli B2 (original ose kopje të vërtetuar në noter) dhe sundim të aftësive të posaçme – punë me kompjuter.

- Kandidati për vendin e punës me numër rendor 2, ka të bëjë për – Këshilltar në Departamentin për resurse njerëzore; dhe duhet të ketë të mbaruar PSP – shkalla VII/1 (shtatë) – diplomë universitare nga sfera e shkencave shoqërore. Është e nevojshme që së paku të ketë 1 (një) vjet përvojë pune. Kandidati duhet të parashtrorë diplomë ose certifikatë për fakultet të mbaruar (original ose kopje të vërtetuar në noter) dhe vërtetim për përvojën e punës (listë nga SIPM). Gjithashtu duhet të ketë edhe kualifikime, aftësi dhe shkathtësi të tjera profesionale, kualitete personale ndërsa posaçërisht: dëshmi për njohje të gjuhës angleze me dorëzimin e certifikatës minimum niveli B2 (original ose kopje të vërtetuar në noter) dhe sundim të aftësive të posaçme – punë me kompjuter.

- Kandidati për vendin e punës me numër rendor 3, ka të bëjë për – Këshilltar për çështje juridike (me fakultet juridik) Departamenti për çështje juridike; dhe duhet të ketë të mbaruar PSP – shkalla VII/1 (shtatë) – diplomë universitare nga sfera e shkencave juridike, me së paku 240 kredi sipas SETK. Është e nevojshme që së paku të ketë 3 (tre) vjet përvojë pune. Kandidati duhet të parashtrorë diplomë ose certifikatë për fakultet të mbaruar (original ose kopje të vërtetuar në noter) dhe vërtetim për përvojën e punës (listë nga SIPM). Gjithashtu duhet të ketë edhe kualifikime, aftësi dhe shkathtësi të tjera profesionale, kualitete personale ndërsa posaçërisht: dëshmi për njohje të gjuhës angleze me dorëzimin e certifikatës minimum niveli B2 (original ose kopje të vërtetuar në noter) dhe sundim të aftësive të posaçme – punë me kompjuter.

- Kandidati për vendin e punës me numër rendor 4, ka të bëjë për – Këshilltar në Departamentin për punë të përgjithshme; dhe duhet të ketë të mbaruar PSP – shkalla VII/1 (shtatë) – diplomë universitare nga sfera e shkencave shoqërore, me së paku 240 kredi sipas SETK. Licencë për sigurim fizik dhe teknik nga Oda e Republikës së Maqedonisë për sigurim privat. Është e nevojshme që së paku të ketë 4 (katër) vjet përvojë pune. Kandidati duhet të parashtrorë diplomë ose certifikatë për fakultet të mbaruar (original ose kopje të vërtetuar në noter) dhe vërtetim për përvojën e punës (listë nga SIPM). Gjithashtu duhet të ketë edhe kualifikime, aftësi dhe shkathtësi të tjera profesionale, kualitete personale ndërsa posaçërisht: dëshmi për njohje të gjuhës angleze me dorëzimin e certifikatës minimum niveli B2 (original ose kopje të vërtetuar në noter) dhe sundim të aftësive të posaçme – punë me kompjuter.

- Kandidati për vendin e punës me numër rendor 5, ka të bëjë për – Këshilltar në Departamentin për marrëdhënie me publikun; dhe duhet të ketë të mbaruar PSP – shkalla VII/1 (shtatë) – diplomë universitare nga sfera e shkencave shoqërore, me së paku 180 kredi sipas SETK. Pa përvojë pune. Kandidati duhet të parashtrorë diplomë ose certifikatë për fakultet të mbaruar (original ose kopje të vërtetuar në noter). Gjithashtu duhet të ketë edhe kualifikime, aftësi dhe shkathtësi të tjera profesionale, kualitete personale ndërsa posaçërisht: dëshmi për njohje të gjuhës angleze (original ose kopje të vërtetuar në noter) dhe sundim të aftësive të posaçme – punë me kompjuter.

Orët e punës për vendet e punës me numër rendor 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 gjatë javës është 40. Dita e punës zgjatë 8 orë edhe atë me fillim prej ora 07:30 deri në ora 15:30, ditët e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte.

Neto pagesa bazë për kandidatin për vendin e punës me numër rendor 1 është: 56.485,00 denarë.

Neto pagesa bazë për kandidatin për vendin e punës me numër rendor 2, 3, 4, 5 dhe 6 është: 41.273,00 denarë.

Dokumentet të parashtrohen në original ose kopje të vërtetuar në noter, në lokalet e “M-NAV” SHA Shkup në adresën: rr. Makedonija nr. 25, objekti Ljazar Pop Trajkov, 1000 Shkup. Dokumentet e pakompletuara dhe të parashtruaras pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit. Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor. Në afat prej 3 ditëve nga dita e kalimit të afatit për paraqitje të kandidatëve, do të realizohet zgjedhja.

“M-NAV” SHA Shkup



TNCP Balkan – Mediterranean 2014 – 2020
The project is co-funded by the European Union and National Funds of the participating countries



REPUBLIC OF MACEDONIA
Ss. CYRIL AND METHODIUS UNIVERSITY IN SKOPJE
FACULTY OF ELECTRICAL ENGINEERING AND INFORMATION TECHNOLOGIES



Our ref: BMP1/2.2/2338/2017-31

Fakulteti i Inzhinierisë Elektrike dhe Teknologjive të Informacionit të Ss. Universiteti “Shën Cirili dhe Metodi” në Shkup po shpall një

FTESË PËR TENDERË PËR shërbimet e ekspertëve të jashtëm brenda projektit “PV-ESTIA – Enhancing storage integration in buildings with Fotovoltaics” me dy /2/ Shumë:

- Shumë 01: Eksperti i jashtëm për specifikimet e projekteve pilot dhe politikën kombëtare
Shumë 02: Eksperti i jashtëm për grumbullimin dhe analizën e të dhënave të projekteve pilot

Procedura që do të aplikohet për këtë njoftim është procedura e vetme e tenderit sipas rregullave PRAG. Dosja e plotë e tenderit mund të gjendet në faqen e internetit të Fakultetit (<http://www.feit.ukim.edu.mk/fakultet/stopanstvo/oghlasji-i-javni-povitsi>). Ai përfshin:

- A. Udhëzimet për ofertuesit dhe njoftimi për kontratë**
- B. Hartimi i Marrëveshjes së Kontratës dhe Kushteve të Veçanta me anekset:**
 - I. Kushtet e përgjithshme për kontratat e shërbimit
 - II. Termat e referencës
 - III. Organizata dhe Metodologjia (do të dorëzohet nga tenderuesi duke përdorur shabllonin e ofruar)
 - IV. Ekspertët kryesorë (duke përfshirë shabllonet për listën përmbledhëse të ekspertëve dhe CV-të e tyre) kanë kontrata që kërkojnë ekspertë kryesorë)
 - V. Buxheti (që do të dorëzohet nga tenderuesi si ofertë financiare duke përdorur shabllonin e ofruar)
 - VI. Formularët dhe dokumentet tjera mbështetëse
- C. Informacione të tjera:**
 - I. Rrjetin e pajtueshmërisë administrative
 - II. Rrjetin e vlerësimit
- D. Formulari i dorëzimit të tenderit dhe deklarata e nderit për përjashtimin dhe kriteret e përzgjedhjes**

Për hollësi të plota të procedurave të tenderimit, ju lutemi shihni **Practical Guide and its annexes (PRAG)**, të cilat mund të shkarkohen nga faqja në vijim:

<http://ec.europa.eu/europeaid/prag/document.do>

Ne mezi presim të marrim tenderin tuaj përpara afatit të përcaktuar në pikën 8 të Udhëzimeve për Tenderuesit. Ju lutem dërgoni në adresën dhe me kërkesat e dhëna në pikën 8. Me dorëzimin e një tenderi ju pranoi që të merrni njoftimin për rezultatit e procedurës me anë të mjeteve elektronike. Nëse vendosni të mos dorëzoni një tender, ne do të ishim mirënjohës nëse mund të na informoni me shkrim, duke treguar arsyet për vendimin tuaj.

Skopje, 15.12.2017

KUPA, ZHVILLOHET NDESHJA KTHYESE MES SHKUPIT DHE VARDARIT

SHKUPIT I KONVENON EDHE BARAZIMI PA GOLA, VARDARI NËN PRESION

“Edhe pse kemi një rezultat pozitiv, por është diferencë minimale. Jemi përgatitur gjatë kësaj kohe dhe besoj se kemi arritur ta kompletojmë ekipin që në duelin e të dielës të nxjerrim rezultat pozitiv, e që në këtë rast për ne do të ishte i mjaftueshëm edhe barazimi pa gola”, thotë Nuhiu



derisa djemtë e trajnerit Ardian Nuhiu edhe me rezultatit e barabartë pa gola, do të plasohen në çerekfinale. Pikërisht trajneri Nuhiu për këtë sfidë thotë se asgjë s'ka përfunduar dhe i presin 90-të minutat që sipas tij nuk do të jenë aspak të lehta. “Sigurisht se asgjë

nuk ka përfunduar nga ndeshja e parë, na presin edhe 90 minuta mjaft të rëndësishme e që nuk do të jenë aspak të lehta. Edhe pse kemi një rezultat pozitiv, por është diferencë minimale. Jemi përgatitur gjatë kësaj kohe dhe besoj se kemi arritur ta kompletojmë eki-

pin që në duelin e të dielës të nxjerrim rezultat pozitiv, e që në këtë rast për ne do të ishte i mjaftueshëm edhe barazimi pa gola. Sigurisht se për ne do të jetë mungesë që nuk luajmë në fushën tonë, por nuk do të na mungojë përkrahja e tifozëve tanë edhe në Gjorçe Petrov, që besoj në fund të gëzohemi në kualifikim të çerekfinale”, deklaroi Nuhiu. Ndërkohë, Shkupi në këtë ndeshje do të jetë pa dy futbollistë, Emmanuel Mbeli i cili është lënduar në ndeshjen e fundit ndaj Vardarit, si dhe vazhdon të jetë jashtë terrenit edhe Bunjamin Shabani, për këtë ndeshje pritet rikthimi i Husein Demirit, i cili u lëndua në ndeshjen e parë të 1/8 së Kupës në duelin ndaj Vardarit.

“SHVERCERAT” MARSHOJNË DREJT “GJORÇES”

Përkundër vendimit që ndeshja kthye ndërmjet Shkupit dhe Vardarit të luhet në stadiumin në “Gjorçe Petrov”, futbollistët e skuadrës nga Çairi do të kenë përkrahjen e tifozëve të tyre “Shvercerat Shkup”. Në faqen e tyre zyrtare në “Facebook” ky grup ka paralajmëruar se në mënyrë të organizuar do të udhëtojnë në “Gjorçe Petrov” për të përkrahur ekipin e tyre të zemrës, i cili kushtimisht thënë do të jetë nikoqir në këtë ndeshje. “Shkupi – Vardari luhet të dielën. Tubimi do të bëhet te parku i Çairit dhe më pas së bashku marshojmë ‘Gjorçen’. Mos mungo, bëhu edhe ti pjesë e Shkupit”, thuhet në lajmërimin e “Shvercerave”.

Koha

Bujar KURTAJ

Shkup, 15 dhjetor – Ndeshja kthye e 1/8 së finale të Kupës së Maqedonisë ndërmjet Shkupit dhe Vardarit do të zhvillohet të dielën në stadiumin “Gjorçe Petrov, për shkak të mungesës së kushteve në stadiumin në Çair. Cekim, edhe ndeshja e parë kur Vardari ishte nikoqir u zhvillua në këtë stadium dhe ndeshja përfundoi baras 1-1, derisa në cilësinë e nikoqirit tani do të jetë skuadra e Shkupit. Në këtë ndeshje gjithçka është e hapur, ndërsa presioni pa dyshim se bie mbi futbollistët e Vardarit, të cilëve nuk ju konvenon rezultati i ndeshjes së parë dhe do të bëjnë gjithçka për të anuluar të njëjtën,

Nga Ferizaj në Tetovë

Shkup, 15 dhjetor – Talenti ferizajas, Leard Sadriu, ka nënshkruar kontratë me ekipin e parë të Shkëndijës së Tetovës bën të ditur gazeta “Zëri”. Drejtori sportiv i klubit, Genc Hyseni është ai që ka zhvilluar bisedime me drejtuesit e klubit Tetovar për 5 ditë. Marrëveshja është arritur dhe Sadriu do të jetë

pjesë e Shkëndijës. Leard Sadriu përndryshe ka qenë pjesë e grupmoshave të KF Ferizaj si dhe ka qenë pjesë e përfaqësueses së Kosovës U17. Klubi amë i ka uruar fat në aventurën e re. Ferizaj është duke punuar për ta krijuar kryesinë e re dhe për të punuar që të kthehen në Superligë.



Khaka kritikohet ashpër nga tifozët

Mesfushori ka marrë kritika të shumta nga tifozët e skuadrës, të cilët kanë shprehur dëshpërimin e tyre me paraqitjet që ai deri tani ka regjistruar në fanellën e Topçinjeve. Granit Khaka ka marrë kritika të shumta nga tifozët të zhgënjyer me paraqitjet e tij në fanellën e Arsenal. Mesfushori i Zvicrës ishte titullar në barazimin e Topçinjtë me Uest Brom, e treta ndeshje me radhë të cilën nuk arritën ta fitojnë të përzgjedhurit e Arsen Venger, transmeton Klan Kosova. Por 25 vjeçari u duk i plogësht dhe shpesh i pasigurt në mbrojtje, teksa dështoi të lërë mbresa në fazën e sulmit pasi e humbi topin shumë shpesh në zona të mira dhe më shumë e pasoi atë anash sesa përpara.



Lucas Arnold
@LucasArnold93
Really disappointed in Khaka. Was always frustrated when we played Arteta CDM in recent years. Set the tempo, passed averagely and defended poorly. Felt we could be a lot better there but unfortunately Khaka only been worse #afc
10:47 AM - Dec 14, 2017 - Camberwell, London

The Dark One™
@DarkOneNero
Despite NLD win, I am wondering if we will finish on top 6 🤔 Wenger still don't see that Alexis is a virus in the starting XI, iwobi is the useless player ever, Khaka don't have the talent we all think he has, Wilshere is the one who should start.. whatever let's wait and see
10:43 AM - Dec 14, 2017

APOEL interesohet për Avdijajn

Donis Avdijaj me shumë gjasa do të largohet nga Schalke gjatë mini-afatit të janarit. Futbollisti i Përfaqësueses së Kosovës ka pasur disa probleme të mëdha me trajnerin e skuadrës gjermane, Domenico Tedesco, duke humbur kështu vendin startues dhe bankën rezervë. Kjo situatë nuk po i pëlqen aspak kosovarit, i cili është duke kërkuar një klub të ri. Klubi i parë dhe serioz që ka shprehë interesim për t'i siguruar shërbimet e Donisit është APOEL Nikosia. Lajmi është konfirmuar edhe nga mediat qipriotë. Përveç Avdijajt, APOEL-i i cili ishte në grup të Ligës së Kampionëve me Dortmundin, Real Madridin dhe Tottenhamin, është interesuar edhe për lojtarin e Shqipërisë, Ergys Kaçen.



Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 145/2014), nenit 80, 82 dhe 130 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 14/2014 dhe 116/2014) dhe Pëlqimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës – Shkup, SHFK "Simçe Nastovski" f. Vratnicë publikon

SHPALLJE

Për pranimit të punëtorëve për kohë të caktuar deri më 31.08.2018 për vitin shkollor 2017/2018

- Një mësimdhënës të mësimin klasor për paralelet me mësim në gjuhën shqipe me 20 orë mësimore, 40 orë pune në javë, prej ditës së hënë deri ditën e premte, orari i punës prej ora 07,30 deri në ora 13,30, me pagesë themelore prej 21.000,00 denar;
- Një mësimdhënës të gjuhës maqedonase për paralelet me mësim në gjuhën shqipe me 10 orë mësimore, 20 orë pune në javë, gjatë ditës së hënë, të martë dhe të mërkurë, orari i punës prej ora 07,30 deri në ora 13,30, me pagesë themelore prej 10.500 denarë
- Një mësimdhënës të matematikës për paralelet me mësim në gjuhën maqedonase me 17 orë mësimore, 34 orë pune në javë, prej ditës së hënë deri ditën e premte, orari i punës prej ora 07,30 deri në ora 13,30, me pagesë themelore prej 17.850,00 denarë
- Një mësimdhënës të informatikës për paralelet me mësim në gjuhën maqedonase me 3 orë mësimore, 6 orë pune në javë, gjatë ditës së martë dhe të mërkurë, orari i punës prej ora 07,30 deri në ora 13,30, me pagesë themelore prej 3.150,00 denarë
- Një mësimdhënës të gjuhës frënge për paralelet me mësim në gjuhën shqipe me 8 orë mësimore, 16 orë pune në javë, gjatë ditës së hënë, të martë dhe të enjte, orari i punës prej ora 07,30 deri në ora 13,30, me pagesë themelore prej 8.400,00 denarë
- Një mësimdhënës të biologjisë për paralelet me mësim në gjuhën shqipe me 6 orë mësimore, 12 orë pune në javë, gjatë ditës së mërkurë dhe të premte, orari i punës prej ora 07,30 deri në ora 13,30, me pagesë themelore prej 6.300,00 denarë
- Një mësimdhënës të etikës për paralelet me mësim në gjuhën shqipe me 1 orë mësimore, 2 orë pune në javë, gjatë ditës së hënë, orari i punës prej ora 08,45 deri në ora 9,25, me pagesë themelore prej 1.050,00 denarë
- Një mësimdhënës të shkencave natyrore për paralelet me mësim në gjuhën shqipe me 6 orë mësimore, 12 orë pune në javë, gjatë ditës së mërkurë dhe të premte, orari i punës prej ora 07,30 deri në ora 13,30, me pagesë themelore prej 6.300,00 denarë,

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme të parapara me nenin 77 paragrafi 2 dhe 3, nenin 79a dhe nenin 80 të Ligjit për arsim fillor dhe akteve të shkollës dhe

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- të ketë arsim përkatës;
- të njej gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik;
- të ketë të dhënë provim profesional për mësimdhënës.

Së bashku me lutjen kandidatët duhet të parashtrojnë edhe dokumentet në vijim në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter:

- dëshmi për përgatitje të mbaruar përkatëse profesionale;
- certifikatë të lindjes;
- certifikatë të shtetësisë së RM;
- certifikatë se me vendim të plotfuqishëm nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- certifikatë për gjendjen shëndetësore fizike dhe psikike;
- certifikatë për provim të dhënë profesional për mësimdhënës.

Shpallja zgjatë 5 ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor.
Zgjedhja në lidhje me shpalljen do të realizohet në afat prej 15 ditëve nga dita e përfundimit të të njëjtit.
Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrohen:
SHFK "Simçe Nastovski" f. Vratnicë
Telefoni 070 915-790
Personi për kontakt: Dijana Petrovska
Dokumentet e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh.

SHFK "Simçe Nastovski" f. Vratnicë
Drejtor, Dijana Petrovska

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 34/14 dhe 113/14) në pajtim me nenin 80 dhe nenin 82 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41, 116/14, 135/14) dhe Pëlqimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nën nr. 12-10979/2 të datës 05.12.2017 SHFK "Strasho Pinxhur" – Karbinci publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim për kohë të caktuar të punës deri më 31.08.2018

- Mësimdhënës të arsimit qytetar me 5 orë mësimore, shkalla VII/1 – 1 realizues dhe neto pagesa prej 5.160 den.
- Mësimdhënës për inovacione me 3 orë mësimore, shkalla VII/1 – 1 realizues dhe neto pagesa prej 3.090 den.
- Mësimdhënës për informatikë me 8 orë mësimore dhe projekte nga informatika (zgjedhore) me 4 orë mësimore, shkalla VII/1 – 1 realizues dhe neto pagesa prej 12.360 den.
- Mësimdhënës për gjuhë maqedonase për nxënësit e bashkësive të tjera me 6 orë mësimore, shkalla VII/1 – 1 realizues dhe neto pagesa prej 6.402 den.
- Mësimdhënës për biologji me 4 orë mësimore dhe shkenca natyrore me 16 orë mësimore, shkalla VII/1 (deri në kthimin e punëtorit që mungon drejtor)-1 realizues dhe neto pagesë prej 20.640 den.
- Mësimdhënës për edukatë fizike me 9 orë mësimore, shkalla VII/1 – 1 realizues dhe neto pagesa prej 9.751 den.
- Mësimdhënës për etikë me 3 orë mësimore, shkalla VII/1 – 1 realizues dhe neto pagesa prej 3.090 den.
- Mësimdhënës për etikë të religjioneve me 6 orë mësimore, shkalla VII/1 – 1 realizues dhe neto pagesa prej 6.402 den.
- Mësimdhënës për mësim klasor për mësimin në gjuhën turke në SHP Oxhalia me 20 orë mësimore, shkalla VII/1 – 1 realizues dhe neto pagesa prej 20.640 den.
- Mësimdhënës për mësim klasor për mësimin në gjuhën turke me 20 orë mësimore, shkalla VII/1 – 1 realizues dhe neto pagesa prej 20.640 den.
- Mësimdhënës për mësim klasor për mësimin në gjuhën turke me 20 orë mësimore, shkalla VII/1 – 1 realizues dhe neto pagesa prej 20.640 den.
- Mësimdhënës për mësim klasor për mësimin në gjuhën turke me 20 orë mësimore, shkalla VII/1 – 1 realizues dhe neto pagesa prej 20.640 den.
- Mësimdhënës për mësim klasor për mësimin në gjuhën turke me 20 orë mësimore, shkalla VII/1 – 1 realizues dhe neto pagesa prej 20.640 den.
- Mësimdhënës për mësim klasor për mësimin në gjuhën turke me 20 orë mësimore, shkalla VII/1 – 1 realizues dhe neto pagesa prej 20.640 den.
- Mësimdhënës për mësim klasor për mësimin në gjuhën turke me 20 orë mësimore, shkalla VII/1 – 1 realizues dhe neto pagesa prej 20.640 den.

SHFK "Strasho Pinxhur" Karbinci
Tel për kontakt:
032/300-002

Në bazë të nenit 22 ndërsa në lidhje me nenin 1 nga Ligji për marrëdhënie pune (Gaz. zyrtare e RM nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 74/15, 167/15, 27/16), neni 142 nga Ligji për mbrojtje të fëmijëve (Gaz. Zyrtare e RM nr. 23/2013, 12/2014, 44/2014, 144/2014, 10/2015, 25/2015, 50/2015, 27/16, 163/17) dhe pajtimi me shkrim nr. 18-11980/2 prej 29.11.2017, dorëzuar nga Ministria e Financave të RM si dhe Rregullorja për sistematizim të vendeve të punës në IPKÇF "Detelinka"-Kriva Pallankë nr. 0101-145/2 prej 07.09.2015 IPKÇF "Detelinka" Kriva Pallankë shpall:

SHPALLJE

Për punësim të 1 (një) personi për kohë të pacaktuar të punës për vendin e punës në vijim

- Një realizues për vendin e punës.....magazininier (nikoqir)
- Me arsim të mesëm të mbaruar
- Me ose pa përvojë pune
- Të ketë leje të vozitjes të kategorisë B
- Orari i ditor i punës: 8 orë (prej orës 7:00 – 15:00)
- Orari javor i punës: 40 orë (prej të hënës deri të premten)
- Neto paga themelore: 13.171,00 den.

Përpos kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për marrëdhënie pune kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e vërtetuara me nenin 142 nga Ligji për mbrojtje të fëmijëve (Gaz. Zyrtare e RM nr. 23/2013, 12/2014, 44/2014, 144/2014, 10/2015, 25/2015 dhe 150/2015, 27/2016).

Dokumentet e nevojshme për paraqitje:

- Paraqitje për punësim;
- Biografi të shkurtë;
- certifikatë shtetësisë së Republikës së Maqedonisë;
- të njej gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik;
- vërtetim mjekësor që personi është i shëndoshë psiko-fizik;
- vërtetim që nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës;
- vërtetim që nuk i shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën dënohet për vepra penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për vepra penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese;
- të përmbushë edhe kushte të tjera të përcaktuara me aktin për organizim dhe sistematizim të brendshëm të vendeve të punës,
- të ketë të dhënë provimin për vozitës të kategorisë "B"

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentacionin e nevojshëm parashtrohen në zarf të mbyllur të pashënur në Drejtorinë e IPKÇF "Detelinka" Kriva Pallankë ose përmes postës në adresën në vijim rr."Sv. Joakim Osogovski" nr. 51 Kriva Pallankë, me shenjë në vijim "për shpallje publike për magazinier (nikoqir)".

Afat për parashtimin e fletëparaqitjeve është 5 ditë pune nga dita e publikimit të shpalljes në gazetën ditore, duke mos konsideruar ditën e publikimit në gazetën ditore. Zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas kalimit të afatit për paraqitje. Fletëparaqitjet e dorëzuara pas afatit, jo të plota dhe jo të rregulluara nuk do të jenë lëndë shqyrtimi.

IPKÇF "Detelinka Kriva Pallankë

Në bazë të vendimit Vendimit të Qytetit të Shkupit nr. 07-7450 të datës 30.10.2014, pëlqimit të marrë nga Kryetari i Qytetit të Shkupit nr. 08-6968/2 të datës 11.12.2017 dhe Vendimit të Këshillit të shkollës nr. 02-970/3 të datës 31.08.2017 dhe nenit 101 të Statutit të SHMQSH "Zdravko Cvetkovski" – Shkup, Drejtori më datë 14.12.2017 publikon

SHPALLJE

Për dhënie me qira të objektit nën hapësirën e shkollës

SHMQSH "Zdravko Cvetkovski" – Shkup, me seli në rr. "Partizanski Odredi" nr. 91 Shkup, tel. 02/3062-694

1. Ofertues:

Të drejtë për parashtim të kërkesës për qira të pronës së theksuar të patundshme ka çdo subjekt fizik ose juridik.

2. Lënda e qirasë:

- Hapësirë shkollore – klasë, me nr. të vlerësimit 05-345/2017 të datës 25.08.2017, në kuadër të shkollës SHMQSH "Zdravko Cvetkovski" Shkup
- Hapësirë shkollore – sallë e brendshme, me nr. të vlerësimit 05-344/2017 të datës 25.08.2017, në kuadër të shkollës SHMQSH "Zdravko Cvetkovski" Shkup
- Hapësirë shkollore – sallë e jashtme, në kuadër të shkollës SHMQSH "Zdravko Cvetkovski" Shkup

Kushtet për marrje me qira të hapësirës afariste:

- Hapësirë shkollore – klasë, me nr. të vlerësimit 05-345/2017 të datës 25.08.2017 me çmim të vetëm fillestar për dhënie prej 18.04 euro në kundërvlerë denarë pa TVSH të përllogaritur sipas kursit mesatar të BPRM për periudhë deri më 10.06.2018, në pajtim me Rregulloren për kushtet dhe mënyrën e dhënies me qira të pronës së patundshme në pronësi të Qytetit të Shkupit

- Hapësirë shkollore – sallë e brendshme, me nr. të vlerësimit 05-344/2017 të datës 25.08.2017 me çmim të vetëm fillestar për dhënie prej 12,5 euro për orë në kundërvlerë denarë pa TVSH të përllogaritur sipas kursit mesatar të BPRM për periudhë deri më 10.06.2018, në pajtim me Rregulloren për kushtet dhe mënyrën e dhënies me qira të pronës së patundshme në pronësi të Qytetit të Shkupit. **Terminët e lira për dhënie të sallës së brendshme janë:** E hënë prej ora 20:00 deri në ora 24:00; e mërkurë prej ora 20:00 deri në ora 24:00; dhe e premte prej ora 20:00 deri në ora 24:00;

- Hapësirë shkollore – sallë e jashtme, me nr. të vlerësimit 05-343/2017 të datës 25.08.2017 me çmim të vetëm fillestar për dhënie prej 14,52 euro për orë në kundërvlerë denarë pa TVSH të përllogaritur sipas kursit mesatar të BPRM për periudhë deri më 10.06.2018, në pajtim me Rregulloren për kushtet dhe mënyrën e dhënies me qira të pronës së patundshme në pronësi të Qytetit të Shkupit. **Terminët e lira për dhënie të sallës së brendshme janë:** E hënë prej ora 20:00 deri në ora 24:00; e martë prej ora 22:00 deri në ora 24:00; e mërkurë prej ora 20:00 deri në ora 24:00; e enjte prej ora 22:00 deri në ora 24:00; dhe e premte prej ora 20:00 deri në ora 24:00;

Ofertuesit duhet të parashtrojnë certifikatë nga Regjistri qendror për vitin 2017, bonitet dhe ofertat të dorëzohen me dokumentacion të nënshkruar dhe vërtetuar nga ana e ofertuesit. Oferta e cila nuk do të dorëzohet me dokumentacionin e nënshkruar dhe të vërtetuar nga ana e ofertuesit, si dhe oferta e cila nuk do të përmbajë të gjitha dokumentet e nevojshme do të llogaritet si e pakompletuar dhe si e tillë nuk do të merret parasysh gjatë shqyrtimit. Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit. Të gjitha ofertat që do të arrijnë më vonë nuk do të merren parasysh. Hapja dhe leximi i ofertave për hapësirën e shkollës – klasa, për hapësirën e shkollës – sallë e brendshme dhe hapësirën e shkollës – sallë e jashtme, në kuadër të shkollës do të mbahet më datë 22.12.2017 në ora 12:00.

SHMQSH "Zdravko Cvetkovski" – Shkup

Drejtor
Dragica Kostadinovska

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 pika 1 dhe neni 23 nga Ligji për marrëdhënie pune (Gazeta zyrtare e RM nr. 62/2005 – 27/2016), dhe miratimi nga ana e Ministrisë për arsim dhe shkencë nr. 12-11025/3 prej 12.12.2017, Shkolla e mesme e Qytetit të Shkupit "Koço Racin", shpall:

KONKURSI

për plotësimin e vendeve të lira të punës për kohë të caktuar deri më 31.08.2018

Publikohet shpallje për plotësimin e vendeve të punës në vijim:

- Mësimdhënës i pedagogjisë të kryer fakultetin Filozofik – grupi pedagogji, 20 orë mësimore, punë me ndërrime, paga fillestare 20.694,00 denarë.
- Mësimdhënës i filozofisë me fakultet të mbaruar filozofik – grupi filozofi, 13 orë mësimore, punë me ndërrime, paga fillestare 13.640,00 denarë.
- Mësimdhënës i edukatës muzikore me studime të mbaruara të Akademisë muzikore – drejtimi mësimor, 13 orë mësimore, punë me ndërrime, paga fillestare 13.640,00 denarë.
- Mësimdhënës i kimisë me studime të mbaruara nga kimia, drejtimi mësimor, kimia me drejtime të tjera me PPPM, 20 orë mësimore, punë me ndërrime, paga fillestare 20.694,00 denarë.

Kandidatët duhet t'i përmbushin kushtet për mësimdhënës të përcaktuara në nenin 59 të Ligjit për arsim të mesëm:

- Të kenë të mbaruar studimet përkatëse për arsim të fakultetit, shkollë të lartë ose akademi.
- Të kenë të mbaruar arsim sipëror të grupit jomësimor të studimeve mësimore, gjeëgjësisht të studimeve që nuk kanë drejtim mësimor dhe të kenë përgatitje pedagogjike-psikologjike dhe metodike në institucione të akredituara për arsim sipëror.
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë dhe të njej gjuhën dhe alfabetin në të cilin zhvillohet mësimi.

Për kandidatët e paraqitur të cilët i përmbushin kushtet nga shpallja do të organizohet testim për njohje të gjuhës dhe alfabetit në të cilën zhvillohet mësimi.

Orari i punës i arsimtarëve është në dy ndërrime dhe atë:

Ndërrimi i parë prej ora 7,30 deri ora 13,30, ndërsa ndërrimi i dytë prej orës 13,30 deri në ora 19,00.

Puna javore është 40 orë, e sistemuara në 5 ditë pune.

Dokumentacioni i nevojshëm së bashku me fletëparaqitjet kandidatët duhet të parashtrojnë:

- Diplomë ose vërtetim për arsim të kryer origjinal ose kopje e notizuar.
- Certifikata e shtetësisë të R.M
- Certifikatë për përgatitje pedagogjike-psikologjike dhe metodike

Konkursi zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e shpalljes në gazetën ditore.

Përzgjedhja e kandidatëve të paraqitur do të kryhet në afat prej 20 ditë pas mbylljes së shpalljes.

Dokumentet e dorëzuara me vonesë dhe jo të kompletuara nuk do të merren parasysh.

Dokumentet të dorëzohen me postë ose në arkivin e Shkollës e mesme e Qytetit të Shkupit "Koço Racin", rr. Lihnida nr. 3.,-1000 Shkup, rel. 2037-073

Shkolla e mesme e Qytetit të Shkupit "Koço Racin"

I nr. 1958/2016	
SHPALLJE PUBLIKE	
Sipas nenit 46-b të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për përmbnim Gazeta Zyrtare e RM nr. 8 të datës 17.01.2008 ndërsa në lidhje me nenin 265 të LP Gazeta Zyrtare e RM nr. 72/2016 të datës 12.04.2016	
Përmbarusi Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari në bazë të kërkesës për realizim të përmbnim nga kreditori Haik Bank SHA Shkup nga Shkupi me seli në rr. "Sv. Kiril i Metod" nr. 54, bazuar në dokumentin për përmbnim Aktit notarial ODU nr. 121/2015 të datës 20.02.2015 të Noterit Përparim Rexhepi, Gostivar, kundër borxhit Ardijan Ramadani nga Gostivari me seli në f. Bellovishhtë dhe debitori të pengut Qemal Ramadani nga Gostivari me seli në f. Bellovishhtë, për realizim të përmbnim në vlerë prej 1.216.747,00 denarë për lëndën përmbnuese të regjistruar nën I nr. 1958/2016 të datës 06.12.2017.	
FTON	
1. Borxhliun Ardijan Ramadani dhe debitorin e pengut Qemal Ramadani të dy nga Gostivari me seli në f. Bellovishhtë, për shkak të dorëzimit të: <ul style="list-style-type: none"> -Konkluzionit për mënyrën e shlyes së patundshmerisë I nr. 1958/2016 të datës 14.07.2017. -Konkluzion për përcaktim të vlerës së patundshmerisë në bazë nenit 165 të LP I nr. 1958/2016 të datës 23.11.2017. -Konkluzion për shlyjen publike me gojë në bazë të nenit 169, nenit 169, nenit 170 të LP I nr. 1958/2016 të datës 23.11.2017 të gjitha të Përmbarusit Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari. 	
Raport për vlerën e realizuar të vlerës së tregut të pronës së patundshme nr. 0802-355/2 të datës 20.11.2017 të Shoqërisë për shërbime MEDIUS TERRA SHPKNJP Shkup.	
2. Personin Zhivka Ançevska nga Shkupi me banim në bul. Ilinden 9-4 për shkak të dorëzimit të: <ul style="list-style-type: none"> -Lajmërimit nga data 29.11.2017. -Konkluzion për shlyjen publike me gojë në bazë të nenit 169, nenit 169, nenit 170 të LP I nr. 1958/2016 të datës 23.11.2017 të gjitha të Përmbarusit Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari. 	
Në afat prej 1 (një) dite duke konsideruar nga dita e publikimit të kësaj thirrje publike në shtypin ditor.	
PARALAJMËROHEN borxhliu Ardijan Ramadani, debitori i pengut Qemal Ramadani dhe personi Zhivka Ançevska se mënyra e këllitë e dorëzimit konsiderohet si e rregullt dhe se pasojat negative që mund të dalin do t'i barit vetë pala.	
Kjo shpallje paraqet SHPALLJEN E GJASHTË.	
Përmbarus Aleksandar Kuzmanovski	

EDHE PSE POZOI ME FANELLËN E BARÇËS



Çellsit i vihet pas sulmuesit Boakye

Sulmuesi i "Crvena Zvezda", Riçmond Boakye, ka përfunduar në radarët e Çellsit, që kërkon ta marrë në merkaton e janarit, pasi ka shënuar 23 gola në 28 ndeshje zyrtare të luajtura sivjet me skuadrën serbe. "Blutë" kanë nevojë për një sulmues që t'i japin minuta pushimi Alvaro Moratës së blerë për 80 milionë euro nga Real Madridi, gjatë verës së kaluar, pasi belgu Miçy Batshuaji nuk gëzon simpatinë e trajnerit Antonio Konte. Në takimin e kaluar, ku Çellsit fitoi 3-1 ndaj Hadersfeld, Konte aktivizoi Eden Hazard si qendërsulmues, pasi vendosi të lërë pushim Moratën. Në këtë kushte, prioriteti i londinezëve është blerja e një sulmuesit dhe për momentin janë të tërhequr nga Boakye. Sulmuesi i kombëtares së Ganës pëlqehet edhe nga klube të tjera në Evropë duke parë paraqitjen që ka bërë sivjet. Ai ka shkëlqyer në kampionatin serb dhe në Europa League, ku "Crvena Zvezda" është kualifikuar për në 1/16-t e finaleve.

YLLI BRAZILIAN PËLQEN REAL MADRIDIN

Arthur ishte drejtpërdrejt i lidhur me Barcelonën javë më parë, si rezultat i një takimi me Robert Fernandez, drejtor sportiv i klubit katalanas, me të cilin pozoj edhe me fanellën Blaugrana. Sidoqoftë, as Arthur, as Jorge Maçado, agjenti i tij, nuk kanë nënshkruar ndonjë angazhim me klubin e kryesuar nga Josep Maria Bartomeu. Siç ka mësuar "MARCA", lojtari pëlqehet nga trajneri Zidan.

Real Madridi ka marrë një ofertë në ditët e fundit, që ka tërhequr vëmendjen e menaxhmentit sportiv të "Los Blancos". Ky është Arthur (21 vjeç), mesfushori-sulmues i Gremios, i cili është evidentuar si një nga yjet e kampionatit brazilian, duke e çuar ekipin e tij drejt pushtimit të "Copa Libertadores". Në fakt, Gremio de Porto Alegre do të jetë rivali i Real Madridit në finalen e Botërorit për Klube, që do të zhvillohet nesër. Ideja e udhëheqësve të Gremios nuk

është tjetër, përveç marrjes së 50 milionë eurove, që shfaqen si klauzolë e largimit të talentit 21-vjeçar. Reduktimi i mundshëm i çmimit të Arthur do të arrihet në një vonesë, sa i përket kohës së largimit nga Brazili. Gremio dhe futbolli brazilian në përgjithësi janë shitës të lojtarëve të spikatur, pasi nuk mund të konkurrojnë me pagat e ofruara nga ekipet e mëdha evropiane. Arthur ishte drejtpërdrejt i lidhur me Barcelonën javë më parë, si rezultat i një takimi me Ro-

bert Fernandez, drejtor sportiv i klubit katalanas, me të cilin pozoj edhe me fanellën Blaugrana. Sidoqoftë, as Arthur, as Jorge Maçado, agjenti i tij, nuk kanë nënshkruar ndonjë angazhim me klubin e kryesuar nga Josep Maria Bartomeu. Siç ka mësuar "MARCA", lojtari pëlqehet nga trajneri Zidan. Në "Bernabeu" konsiderojnë se do të ishte një shtesë interesante, pasi mendojnë se ky futbollist është një nga më të mirët e tregut brazilian në vitet e fundit, me Viniciusin ta-

shmë të nënshkruar. Burime të afërta me lojtarin e kanë siguruar këtë gazetë spanjolle se Arthur nuk është zotuar për Barcelonën dhe se ekipi brazilian në këtë kohë nuk dëshiron të dijë asgjë për katalanasit e kryesuar nga Josep Maria Bartomeu. Andre Zanotta, ekzekutivi i Gremios, pranoi dhe se klubi i tij nuk mund t'i mbyllë dyert e dëshirës së Arthurit për të luajtur në Evropë, edhe pse qëllimi është të vazhdojnë së bashku deri në vitin 2020, më së paku.



Publicitet

KORRIGJIM I SHPALLJES

Bëhet korrigjim i shpalljes publike të publikuar në gazetën ditore "Veçer" dhe "Koha" më datë 14.12.2017 nga ana e Shoqërisë aksionare Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë, në pronësi të shtetit, Shkup edhe atë në pjesën Filiali Drini i Zi – Ohër me numër rendor 1 tek vendi i punës Drejtor në vend të "5 vjet përvojë pune", duhet të qëndrojë "3 vjet përvojë pune". SHA "Ekonomia e ujërave të RM" – Shkup

URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221

Junajted me ofertë zyrtare për Uillian

Manchester Junajtedi i ka bërë një kërkesë zyrtare Çellsit për të marrë mesfushorin Uillian, por kampionët e Anglisë në fuqi nuk duan të privohen nga braziliani gjatë merkatos së janarit. Vetë Uillian i garantoi tifozët, pas ndeshjes kundër Hadersfeld, se ndihej i dashuruar me ta dhe "Stamford Bridge", por braziliani mund të pranojë të punojë me Hoze Murinjós, duke qenë se nuk ka pasur shumë mundësi nga Antonio Konte në këtë sezon. Junajted ka bërë një ofertë zyrtare për 29-vjeçarin, edhe pse arritja e marrëveshjes duket shumë e vështirë, sepse Çellsit ka mungesë futbollistësh në repartin e avancuar. Miçy Batshuaji është pranë huazimit të Monaco dhe kësaj "blutë" nuk mund të tolerojnë një tjetër largim në janar. Gjithsesi, ekzistojnë të gjitha gjasat që gjatë verës së ardhshme, Uillian të transferohet në "Old



Trafford", ku e pret Hoze Murinjós, i cili e admiron që prej kohës që punuan bashkë te Çellsit, duke fituar kampionatin. Uillian ka luajtur 13 ndeshje në këtë sezon, 11 si titullar, 1145 minuta gjithsej. Ai ka shënuar 5 gola dhe ka dhënë 4 asistime.

“Mirabelli ka një problem personal me mua dhe përdor Gjigjio Donnarumma për të më sulmuar. Por unë nuk do të bëjë atë cirk në media dhe më shumë, nuk dua që kjo të rëndojë në lëkurën e Gjigjio. Unë do t'i përgjigjem Mirabellit në vendet e duhura dhe në kohën e duhur. Gjigjio nuk kanë bërë asgjë të gabuar dhe për këtë arsye nuk është e drejtë ta shfrytëzojë atë për të bërë luftë me mua”, pohon Raiola

RAIOLA I KUNDËRPERGJIGJET MIRABELLIT

DO T'I PËRGJIGJEM MIRABELLIT NË VENDET E DUHURA DHE NË KOHËN E DUHUR



pasur shërbime ekonomike dhe tregtare për Gjigjion, të tilla sa asnjë lojtar nuk do t'i kishte refuzuar. Por Gjigjio dhe familja e tij kanë bërë një zgjedhje me zemër. Dhe e kam respektuar këtë zgjedhje. Interesi im sot është vetëm që Gigio të lihet i qetë, sepse vetëm kështu mund të bëjë më të mirën e tij. Kjo gjë duhet të jetë, gjithashtu, prioritet i drejtorit sportiv të Milanit. Nëse jo, duhet të jetë prioritet i pronarëve të Milanit, apo përfaqësuesve të tyre. Për Mirabellin sot është e rëndësishme për këto polemika, sepse heq vëmendjen nga problemi i vërtetë i Milanit: projekti i tij teknik. Nuk kam asgjë kundër Milanit, me të vërtetë e dua atë dhe dëshiroj që të ketë sukses. Unë jam i interesuar që klientët e mi të arrijnë rezultate të rëndësishme, por nuk është vetëm kjo. Gjithashtu, mendoj se për futbollin italian është e rëndësishme që Milani të kthehet në një faktor kryesor në Itali dhe në planin ndërkombëtar”, deklaroi Raiola.

Xhankarlo Kapelli (kryetari i shoqatës së tifozëve të Milanit)

Donnarumma në këto muaj nuk ka folur kurrë në vetë të parë, por është fshehur pas fjalëve të menaxherit. Tani, gjatë këtyre ditëve kanë dalë gjëra që nuk i bëjnë mirë askujt dhe dëmtojnë skuadrën dhe si rrjedhojë tifozët. Jemi të mërziur nga kjo situatë. Ai thotë se dashuron klubin e Milanit dhe që ndihet i lidhur me këtë. Në fillim duhet të shkëputet nga Raiola. Tani nuk mjaftojnë më fjalët, duam fakte prej tij, që të tregojë dashurinë për klubin dhe tifozët



Përmes një njoftimi të gjatë përshtyp, Mino Raiola iu përgjigjet akuzave të menaxhmentit të Milanit lidhur me polemikat që rrethojnë të ardhmen e portierit të datëlindjes 1999, Gjigjio Donnarumma. Së pari, menaxheri i mirënjohur akuzon drejtorin sportiv Mirabelli për përdorimin e Donnarummas si një justifikim për ta sulmuar atë personalisht. “I marr me sportivitet ato që thotë Mirabelli për mua dhe kundër meje, pasi të gjithë jemi në një vend de-

mokratik dhe mund të themi atë që mendojmë. Mirabelli ka një problem personal me mua dhe përdor Gjigjio Donnarumma për të më sulmuar. Por unë nuk do të bëjë atë cirk në media dhe më shumë, nuk dua që kjo të rëndojë në lëkurën e Gjigjio. Unë do t'i përgjigjem Mirabellit në vendet e duhura dhe në kohën e duhur. Gjigjio nuk kanë bërë asgjë të gabuar dhe për këtë arsye nuk është e drejtë ta shfrytëzojë atë për të bërë luftë me mua. Është e qartë

për të gjithë se problemi i Milanit nuk është Gigio, as Antonio. Çuditërisht, pra, as Mirabelli, as shoqëria nuk e kanë komentuar baner-in që u shfaq në stadium”, thotë menaxheri Raiola. Sipas tij kur nuk ia kanë imponuar Milanit për të marrë Antonion dhe se ajo ka qenë zgjedhje teknike e Mirabellit. “Ne kurrë nuk ia kemi imponuar Milanit për ta marrë Antonion. Ishte një zgjedhje teknike e Mirabellit, që tani duhet të paktën ta mbrojë. Unë dua t’ju kujtoj se këtë verë ka

KUPA E BOTËS “RUSI 2018”

Shiten në kohë rekord biletat VIP me vlerë 1 mln euro



Biletat VIP për Kupën e Botës Rusi 2018, që kapnin çmimin 1 mln euro për 19 ndeshje, janë shitur tashmë. Kjo shumë marramendëse do të lejojë blerësit të shohin të 19 ndeshjet që do të zhvillohen në Stadiumin Luzhniki dhe Spartak të Moskës, si dhe stadiumin e “St Petersburg”. Kjo do të thotë se mbajtësit e biletës 1 milionëshe mund të shohin ndeshjen hapëse, dy gjysmëfinalët dhe finalen. Të gjitha ndeshjet do të shihen nga një dhomë private e rehatshme ku përfshihen ushqimet, pijet dhe parking falas. Duke filluar nga 1 mln euro për biletë, bazuar në vendndodhjen e dhomës, mysafirët do të marrin dhuratat teksa do të shijojnë luksin e biletave. Ata do të kenë edhe një staf të dedikuar për deri në tre orë përpara dhe pas ndeshjes, si edhe gjatë ndeshjes.



Publicitet

udhërrëfyes mjekësi
FAQ. 133

udhërrëfyes mobilie/ndërtimtari
FAQ. 153

libri i artë

2017/18

ZBRITJE DHE GRATISE
24 KUPONË PREMIUM

LEHTË DERI TEK INFORMACIONI

www.zk.mk android app. iPhone app.



Kim Kardashian kalon 13 orë në sallon bukurie

13 orë mbase shumë të vlefshme për të, Kim Kardashian i ka kaluar në një sallon bukurie për t'i rregulluar flokët e saj. Kanë kaluar 3 muaj që kur ajo ka kthyer flokët e saj në të bardhë, duke i rregulluar herë të valëzuara dhe herë të drejta, shkruan People. Kardashian ka thënë se nuk ndihet rehat që rrënjët e saj po ndryshojnë ngjyrë, prandaj ka kaluar 13 orë në një proces të gjatë dhe me shumë kujdes. "O Zot 13 orë dhe do të vazhdojë. Të jesh bionde kërkon shumë mirëmbajtje", ka shkruar ajo në Twitter. Ka thënë se kishte frikë mos flokët do t'i shkatërroheshin, pasi vetëm për raundin e parë të ngjyrosjes i janë dashur 13 orë.

Kapet peshkaqeni 512 vjet i vjetër

Shkencëtarët danez ka kapur një peshkaqen i cili besohet të jetë 512 vjet i vjetër, që do të thotë se ka lindur para William Shakespeare. Ky peshkaqen besohet të jetë kurrizori më i vjetër i gjallë i zbuluar ndonjëherë. Ekspertët kanë determinuar moshën e tij duke përdorur gjatësinë e peshkaqenit, i cili është 5.4 metra, ndërsa ishte më i vjetri nga 28 peshkaqenët e analizuar në Grenlandë.



Skoda sjell seri të limituar të Fabias

Prodhuesi çek ka bërë të ditur të dhënat teknike dhe fotografitë e versionit sportiv të modelit të tij. Në vend të versionit RS, Skoda u ka ofruar blerësve serinë e limituar të modelit Fabia, në ngjyra të cilat janë karakteristika për variantin e këtij automobili. "Fabia Limited Edition" është i bazuar në pakon e pajisjes Monte Karlo dhe do të jetë e pranishme në karrocërinë e bardhë Candy White.

Vetura ka motor 1.4 TSI benzinë me 125 kuaj fuqi, ndërrues automatik prej shtatë shpejtësive DSG, ndërsa nga o-

deri 100 km/h arrin për 8,8 sekonda dhe shpejtësia e saj maksimale është 203 km/h.

Fabia Limited Edition vjen në tregun evropian në shkurt 2018 dhe do të prodhohet në gjithsej 1.300 njësi. Çmimi ende nuk është bërë i ditur.



1431 - Mbreti Henri VI i Anglisë kurorëzohet si mbreti Francës.

1631 - Shpërthen mali Vezuf në Itali duke shkatërruar 6 fshatra dhe duke lënë të vdekur rreth 4000 njerëz.

1707 - Erupsioni i fundit i regjistruar në Malin Fuxhi në Japoni.

1761 - Ushtria ruse okupon Kolbergun.

1824 - Hapet Kanali i Madh në Hollandën Veriore.

1880 - Formohet Republika Jug-Afrikane.

1884 - Britani e Madhe njeh Shtetin e lirë të Kongos.

1912 - Austro-Hungaria futet në konflikt me Serbinë.

1913 - Charlie Chaplin fillon karrierën e tij filmime në Keystone për 150 dollarë në javë.

1942 - Hitleri urdhëron luftën kundër partizanëve në Rusi dhe Ballkan.

1971 - Bangladeshi (Pakistani Lindor) shpall pavarësinë nga Pakistani.

1991 - Shpallet pavarësia e Republikës së Kazakistanit.

Shkrimtari, ilimnisti dhe filozofi francez Volter (1694-1778), i pëlqente që të shkruante i shtrirë në shtrat, veçanërisht në vitet e fundit të jetës së tij. Një vizitor e regjistroi ritualin e përditshëm të Volterit në vitin 1774: Ai e kalon mëngjesin në shtrat, duke lexuar dhe diktuar veprën e tij të re, njëherë nga sekretare-

ve. Në mesditë ai ngrihet dhe vishet. Më pas mund të pranojë vizitorë, por nëse nuk ka të tillë, vazhdon të punojë, duke konsumuar kafe dhe çokollatë për ushqim. (Ai nuk ha drekë.) Midis orës 2 dhe 4 të pasdites, Volteri dhe sekretari i tij kryesor, Zhan Lui Vazhnie, dilnin me karrocë shëtitje, për të shijuar pranverën. Pastaj shkrimtari punonte sërish deri në 8 të mbrëmjes, kur ai do të bashkohej me mbesën e tij të ve (dhe të dashurën e tij për një kohë të gjatë) Madam Deni dhe të tjerët për darkë



A E DINI SE...

PANIKU

Tri shoqe duke pirë kafe dhe duke biseduar:
E para: - Para tri ditësh ia gjeta burrit tim 3 kondoma në xhep. Edhe çfarë ke bërë me ta?, e pyet shoqja e dytë.
- I shpova me gjilpërë!
Shoqja e tretë alivanoset...



Miqtë janë ata që mund t'i telefono-sh nga mesnata, deri në shtatë të mëngjesit. Të tjerët janë thjesht të njohur.

(Wander Knight)

KALENDARI HISTORIK 16 DHJETOR

A E DINI SE...

BARSOLETA

THËNIA E DITËS